REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

# SISTEMI I MENAXHIMIT TË BUXHETIT VENDOR (SMBV)

*Manual për Përdoruesin*

*Versioni 1*

**Shkurt, 2024**

# Tabela e Përmbajtjes


Shkurtimet....1
1. Prezantimi ....2
2. Hyrja në SMBV....5
3. Rolet e përdoruesit....6
4. Problemet....13
5. Përmbledhje e Menyve dhe Ekraneve të SMBV....14
6. Përshkrimi i Menyve të Ekranit ....18
   6.1 Konfigurimi i sistemit nga MF....18
   6.2 Konfigurimi i Sistemit nga Administratori ....18
   6.3 Administrimi i akesit në SMBV....19
   6.4 Mjedisi i Punës i NJVQV-së....19
7. Zona kryesore e ekranit ....25
   7.1 Legjenda e Skemës së Proçesit ....26
8. Ekranet e hyrjes së të dhënave ....27
9. Ministria e Financave (FE) ....29
   9.1 Hapja Vitit/Fazës së Re ....29
   9.2 Faktorët e Modifikimit të Çmimit....31
   9.3 Transfertat nga Buxheti....32
10. Konfigurimet....34
   10.1 Administrative....34
   10.2 Buxhetore....41
11. PBA ....51
   11.1 Parashikimi i të Ardhurave....51
   11.2 Specifikimi i Programeve ....52
   11.3 Planifikimi i Shpenzimeve ....66
   11.4 Raportimi dhe miratimi i planifikimit të shpenzimeve të programit....109
12. Përgatitja e Buxhetit Vjetor ....111
   12.1 FB1. Detajimi i Buxhetit....112
   12.2 FB2. Plani i Arkës....113
   12.3 FB3. Lehtësimet Fiskale ....114
   12.4 FB4. Plani i Menaxhimit të Riskut....115
   12.5 FB5 Subvencionet....116
13. Moduli i Monitorimit të Performancës....117
14. Proçesi i Miratimit të Dokumentacionit të PBA dhe Buxhetit Vjetor....118
15. Përmbledhje e Raporteve ....124
   15.1 Raportet e PBA-së ....124
   15.2 Raportet vjetore të buxhetit....124
   15.3. Raportet e Monitorimit të Performancës....124
16. Shtojcë 1. Planifikimi i Shpenzimeve në Nivel Aktiviteti....126

**Shkurtimet**

| | |
|---|---|
| KB | Këshilli Bashkiak |
| DFV | Drejtoria e Financave Vendore |
| DB | Drejtor i Çështjeve Ekonomike, Financave dhe Buxhetit |
| SP | Sekretar i Përgjithshëm |
| DEMP | Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit |
| SEMP | Sekretari i Ekipit të Menaxhimit të Programit |
| EMP | Ekipi i Menaxhimit të Programit |
| TI | Teknologjia e Informacionit |
| MF | Ministria e Financave |
| PBA | Programi Buxhetor Afatmesëm |
| KGMS | Koordinator i Grupit për Menaxhimin Strategjik |
| SGMS | Sekretari i Grupit për Menaxhimin Strategjik |
| SMBV | Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor |
| DPP | Deklarata e Politikës së Programit |
| PSHP | Planifikimi i Shpenzimeve të Programit |
| FB | Formati i Buxhetit |
| TP | Tregues i Performancës |
| AS | Administratori i Sistemit |
| | |

## 1. Prezantimi

Planifikimi i shpenzimeve të programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe ndjek zhvillimin e Deklaratës së Politikës së Programit. Ai nënkupton fillimin e procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Planifikimi i shpenzimeve të programit kryhet nga NJVQV-të duke përdorur Sistemin e Menaxhimit të Buxheti Vendor (SMBV) të Ministrisë së Financave.

Përdorimi i SMBV shpjegohet në këtë dokument.

Ekzistojnë 6 mjedise kryesore të punës brenda SMBV:

1. Konfigurimi i sistemit nga Administratori
    - ♦ Përditësimi i Klasifikimeve Administrative
    - ♦ Përditësimi i Klasifikimeve Buxhetore
    - ♦ Përditësimi i Roleve
2. Konfigurimi i sistemit nga MF.
    - ♦ Fillimi i një viti dhe faze të re të ciklit të PBA-së.
    - ♦ Hedhja ose plotësimi në SMBV i faktorëve të modifikimit të çmimit për tre vitet e ardhshme të PBA-së.
    - ♦ Hedhja në SMBV e informacionit për transfertat e pakushtëzuara për secilën NJVQV për secilin vit.
    - ♦ Hedhja në SMBV e informacionit për transferet e pakushtëzuara sektoriale për secilën NJVQV për vitin e parë.
3. Parashikimi i të Ardhurave nga NJVQV-të.
4. Përgatitja e PBA-së nga NJVQV-të.
    - 4.1. Specifikimi i Programeve
        - ♦ Struktura e programeve
        - ♦ Ekipi i Menaxhimit të Programit
        - ♦ Deklarata e Politikës së Programit
        - ♦ Të Dhënat Bazë për Programin
    - 4.2. Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (PSHP) nga NJVQV.
        - ♦ Hedhja në SMBV e ndarjes së buxhetit të vitit aktual sipas NJVQV (Entiteti), Programi dhe Artikulli buxhetor.
        - ♦ Hedhja në SMBV e tavaneve përgatitore të PBA-së për NJVQV-të.

- Shpërndarja e tavanit përgatitor të PBA-së të NJVQV-ve sipas programeve.

- Identifikimi i Projekteve të Investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.

- Përgatitja e Pemës së Programit. Identifikimi i produkteve (shërbimeve) të programit dhe shpjegimi i kontributit të tyre në arritjen e objektivave dhe qëllimeve të politikës.
    - Identifikimi i aktiviteteve të produkteve për secilin program.
    - Identifikimi i sasisë së produkteve dhe shpenzimeve të aktiviteteve për vitin aktual dhe planifikimi i sasisë së produkteve dhe shpenzimeve të aktivitetit për vitet e ardhshme.

- Verifikimi i përputhshmërisë së shpenzimeve të aktiviteteve (totali i shpenzimeve të programit) me tavanet sipas artikujve buxhetorë dhe identifikimi dhe mbyllja e mangësive të financimit të programit, dmth. diferencat midis tavanit të programit dhe shpenzimeve të planifikuara të programit.

5. Përgatitja e buxhetit vjetor nga NJVQV.

    - Detajimi i Buxhetit
    - Përgatitja e Planit të Arkës
    - Informacioni mbi Lehtësirat Fiskale
    - Plani i Menaxhimit të Riskut
    - Subvencionet për Shoqëritë Tregtare Publike

6. Monitorimi vjetor i buxhetit nga NJVQV.

Procedurat e PSHP në NJVQV duhet të fillojnë pas përfundimit të procedurave për hartimin e Deklaratës së Politikës së Programit, së paku deri në fazën kur është arritur një marrëveshje brenda NJVQV-ve lidhur me Deklaratat e Politikës së Programeve.

Procesi i planifikimit të shpenzimeve të programit është kompleks dhe përfshin plotësimin ose përdorimin nga NJVQV-të e një sërë ekranesh (formatesh) në SMBV për çdo vit të PBA-së. Procesi duhet të konsiderohet në formën e cikleve.

Cikli fillon me ndarjen e Tavanit Përgatitor të PBA-së sipas programeve. Cikli përbëhet nga katër nëncikle, i pari për vitin buxhetor aktual dhe më pas një për çdo vit pasues të PBA-së.

- Hapi **i parë** në çdo nëncikli është identifikimi i projekteve, produkteve dhe aktiviteteve të programeve për vitin përkatës të nënciklit.

- Hapi **i dytë** është identifikimi i shpenzimeve të aktivitetit për secilin program për vitin përkatës të nënciklit.

- Hapi i **tretë** është të verifikohet përputhshmëria e shpenzimeve të planifikuara të aktiviteteve me tavanin për vitin e nënciklit të parë përpara se të vazhdohet në nënciklin e dytë dhe të eliminohet çdo mangësi financimi e programit (ndryshimet midis tavanit dhe shpenzimeve të planifikuara të programit) përpara se të vazhdohet.

në vitin e ardhshëm të nënciklit. Kur janë eliminuar mangësitë e financimit të programit për vitin e fundit të PBA-së, cikli përfundon.

Pas përfundimit të ciklit (d.m.th., eliminimi i mangësive të financimit të programit për të gjitha vitet), mund të rezultojë që një ose më shumë programe të kenë një buxhet të pamjaftueshëm në fillim të ciklit për të financuar produktet e nevojshme për të arritur objektivat përkatëse të politikës së programit për një ose më shumë vite të PBA-së. Në këtë rast, mund të jetë e përshtatshme që tavanet e PBA-së të rialokohen ndërmjet programeve për të lejuar një nivel më të lartë produkti në ato programe. Rishpërndarja e tavaneve të programit duhet të bëhet vetëm pas përfundimit të një cikli dhe para fillimit të punës në ciklin tjetër.

## 2. Hyrja në SMBV

Aplikacioni SMBV është i instaluar në një server cloud (pra është online dhe i aksesueshëm nëpërmjet internetit) ku DFV dhe NJVQV janë përgjegjëse për menaxhimin e të drejtave të përdoruesve në sistem.

Aksesi në sistem varet nga disponueshmëria e lidhjes së internetit në vendin e punës të përdoruesit dhe dhënia e aksesit në domain (**smbv.fvv.al**) nga departamenti i TI-së i NJVQV-së. Kjo do të thotë që çdo përdorues që dëshiron të hyjë në sistem do të duhet të krijojë një lidhje nga kompjuteri i tij me këtë adresë ueb.

Sigurimi i aksesit në aplikacion kryhet në bashkëpunim ndërmjet Sekretarit të GMS-së, stafit të TI-së të NJVQV-së dhe DFV/MF-së, me mbështetjen e Projektit Financat Lokale (PFL).



## 3. Rolet e përdoruesit

Aplikacioni përdor ***rolet*** për të përcaktuar se çfarë veprimesh lejohet të kryejë një përdorues brenda tij. Me instalimin e aplikacionit online do të aplikohet edhe caktimi i roleve. Rolet kanë katër veçori:

- ⇒ Lexim: Lejon përdoruesin të shikojë informacionin në sistem, por jo ta modifikojë atë.
- ⇒ Modifikim: U jep përdoruesve të drejta të plota mbi informacionin - ata mund të krijojnë, modifikojnë dhe fshijnë të dhëna.
- ⇒ Miratim: U jep përdoruesve të drejta për të miratuar informacionin e shfaqur
- ⇒ Shfuqizim: U jep përdoruesve të drejta për të shfuqizuar një formë të miratuar më parë.

Rolet e caktuara për çdo ekran të sistemit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

| | | | Rolet | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Drejtori DFV | Stafi i DFV | Kryetari GMS | Koordinator GMS | Sekretari i GMS | Drejtori Ardhurave | DEMP | Sekretari i EMP | Anëtar i EMP |
| | **Modulet** | **Privilegjet** | **SA** | **MF 1** | **MF 2** | **NJVQV 1** | **NJVQV 2** | **NJVQV 3** | **NJVQV 4** | **NJVQV 5** | **NJVQV 6** | **NJVQV 7** |
| | **KONFIGURIMI I SISTEMIT** | | | | | | | | | | | |
| | Administrative | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Buxhetore | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Vitet | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | **PANELI MF** | | | | | | | | | | | |
| | Programe të Reja për Miratim | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Projekte të Reja për Miratim | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Produkte të Reja për Miratim | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Hapja e Vitit/Fazës së RE | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Faktorët e Modifikimit | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Transfertat nga Buxheti | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| **PANELI NJVQV** | | | | | | | | | | | | |
| NJVQV1 | Të dhënat bazë të NJVQV | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| NJVQV2 | Struktura Organizative | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| NJVQV3 | Numri i Punonjësve | Lexon | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| NJVQV4 | Detyrimet e Prapambetura | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| NJVQV5 | Njësitë Shpenzuese të NJVQV | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| **PBA** | | | | | | | | | | | | | |
| | Parashikimi i të Ardhurave | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| DPP1 | Struktura e Programeve | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| DPP2 | EMP | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | | |
| DPP3 | Deklarata e Politikës së Programit | Lexon | | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | Informacione Bazë të Programit | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| PSHP1 | Alokimi i Buxhetit të Vitit Korent | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| PSHP2 | Tavanet Përgatitore të PBA-së | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| PSHP3 | Alokimi i Tavaneve për Programet | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| PSHP4 | Projektet e Investimeve | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| PSHP5 | Pema e Programit | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |
| | | Miraton | | | | | | | | | | |
| | | Shfuqizon | | | | | | | | | | |
| | | Lexon | | | | | | | | | | |
| | | Redakton | | | | | | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| | Shpenzimet e Aktiviteteve/Produkteve | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| PSHP6 | Mangësitë e Financimit të Programit | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| PSHP7 | Kërkesa Shtesë të PBA-së | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| | **BUXHETI VJETOR** | |
| FB1 | Detajimi i Buxhetit | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| FB2 | Plani i Arkës | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| FB3 | Përjashtimet Fiskale | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| FB4 | Plani i Menaxhimit të Riskut | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |

| | | |
|---|---|---|
| FB5 | Subvencionet | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| | **MONITORIMI I BUXHETITI** | |
| | Forma e monitorimit 1 | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| | Forma e Monitorimit 2 | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| | Forma e monitorimit 3 | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |
| | Forma e monitorimit 4 | Lexon |
| | | Redakton |
| | | Miraton |
| | | Shfuqizon |

## 4. Problemet

Nëse një përdorues ndesh probleme gjatë përdorimit të SMBV, ai duhet së pari të identifikojë natyrën e problemit përpara se të kërkojë ndihmë, pasi kjo do të përcaktojë se kë të kontaktojë për zgjidhjen e problemit.

⇒ A është problemi i lidhur me funksionalitetin?

Në këtë rast, përdoruesi duhet së pari të konsultohet me ndihmën online të inkorporuar në sistem; një ikonë e gjelbër e ndihmës është gjithmonë e dukshme në anën e poshtme djathtas të ekranit. Nëse ndihma online nuk është në gjendje ta zgjidhë problemin, përdoruesi duhet të kontaktojë specialistin përkatës në DFV të MF dhe të diskutojë natyrën e problemit. Nëse stafi i DFV-së nuk është në gjendje ta zgjidhë problemin, ata duhet të kontaktojnë zyrën e ndihmës së PFL për të gjetur një zgjidhje.

⇒ Apo problemi lidhet me pamundësinë e përdoruesit për t'u lidhur me aplikacionin?

Në këtë rast, përdoruesi duhet së pari të kontaktojë departamentin e TI-së në NJVQV dhe të kontrollojë nëse ka ndonjë problem në rrjetin lokal që pengon lidhjen me aplikacionin SMBV. Departamenti i TI-së i NJVQV-së duhet të marrë përgjegjësinë për zgjidhjen e problemit lokal.

## 5. Përmbledhje e Menyve dhe Ekraneve të SMBV

Përdoruesit ndërveprojnë me aplikacionin SMBV përmes një sërë ekranesh.

### I. Konfigurimi i sistemit nga Administratorët/MF:




### Paneli i MF

Nëpërmjet këtij paneli, përdoruesi nga MF ndërvepron me sistemin dhe NJVQV.

⇒ *Programe të reja për Miratim.*
⇒ *Projekte të reja për Miratim.*
⇒ *Produkte të reja për Miratim.*

### Lista e PBA të NJVQV.

Nëpërmjet kësaj menyje navigohet në PBA e viteve dhe fazave të ndryshme të NJVQV.

### MF

⇒ **MF1: Hapja Vitit/Fazës së Re.**
⇒ **MF2: Faktorët e Modifikimit.**
⇒ **MF3: Transfertat nga Buxheti.**

### KONFIGURIMET

⇒ **Administrative.**




⇒ **Buxhetore.**
⇒ **Vitet.**

**AKSES**

⇒ **Përdoruesit**.
⇒ **Regjistri i Aktiviteteve**.

**II. PANELI I NJVQV-SË**

⇒ NJVQV1: Të dhënat e NJVQV-së
⇒ NJVQV2: Struktura Organizative
⇒ NJVQV3: Numri i Punonjësve
⇒ NJVQV4: Detyrimet e Prapambetura
⇒ NJVQV5: Njësitë Shpenzuese të NJVQV-së

**III. PËRGATITJA E PBA-SË**

**III.1. Parashikimi i të Ardhurave të NJVQV-së:**

⇒ Parashikimi i të Ardhurave

**III.2. Specifikimi i Programeve:**

⇒ DPP1: Struktura e Programeve
⇒ DPP2: Ekipi i Menaxhimit të Programit
⇒ DPP3: Deklarata e Politikës së Programit (Info Bazë të Programit)

**III.3. Planifikimi i Shpenzimeve**

⇒ PSHP1: Alokimi i Buxhetit të Vitit Aktual
⇒ PSHP2: Tavanet Përgatitore të PBA-së
⇒ PSHP3: Alokimi i Tavaneve të PBA-së për Programet
⇒ PSHP4: Projektet e Investimeve
⇒ PSHP5: Pema e Programit
⇒ PSHP6: Mangësitë në Financimin e Programit
⇒ PSHP7: Kërkesat Shtesë

NJVQV-ja shpërndan buxhetin e vitit aktual për programet, përgatit Tavanet Përgatitore Totale të PBA-së, ndan Tavanin Përgatitor të PBA-së për programet, identifikon Projektet e Investimeve, zhvillon Pemën e Programit me produktet dhe aktivitetet e programit, identifikon Sasitë dhe Shpenzimet e Aktiviteteve (për vitin aktual), planifikon. Sasitë dhe Shpenzimet e Aktiviteteve (për vitet e ardhshme të PBA-së), verifikon përputhjen e Shpenzimeve të Planifikuara të Programit

me Tavanet e Programit dhe identifikon dhe mbyll mangësitë e Financimit të Programit, miraton Planet e Shpenzimeve dhe përgatit Kërkesat Shtesë (nëse është e nevojshme).

**IV. BUXHETIT VJETOR**

⇒ FB1: Detajimi i Buxhetit
⇒ FB2: Plani i Arkës
⇒ FB3: Lehtësimet Fiskale
⇒ FB4: Plani i Menaxhimit të Riskut
⇒ FB5: Subvencionet

**V. Monitorimi i Buxhetit**

*[Për t'u specifikuar në versionin e ardhshëm]*

**VI. Raportet**

VI.1. Raportet e MF

Raporti MF1: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Nivelit I, II dhe III të COFOG.
Raporti MF2: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas kategorive ekonomike
Raporti MF3: Të ardhurat e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Tabelës së të Ardhurave
Raporti MF4: Numri i punonjësve të NJVQV-ve sipas programeve dhe funksioneve qeverisëse

VI.2. Raportet e NJVQV-së

⇒ VI.2.A Raportet e PBA-së

Raporti PBA1: Tavanet Përgatitore të PBA
Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)
Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA6: Deklarata së Politikës së Programit
Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit
Raporti PBA8: Projektet e Investimeve
Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin

⇒ VI.2.B Raportet e Buxhetit Vjetor

Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese
Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve
Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave
Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik
Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV
Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore
Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV
Raporti BV8: Efekti Financiar I Përjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale
Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV

Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit
Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura
Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve
Raporti BV13: Lista e Projekteve Koncensionare / PPP
Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike
Raporti BV15: Plani i Arkës

## 6. Përshkrimi i Menyve të Ekranit

### *6.1 Konfigurimi i sistemit nga MF*

**Paneli i MF**

| Emërtimi i Ekranit | Shpjegim i mëtejshëm |
|---|---|
| *Programe të reja për Miratim* | Këtu shfaqen programet e reja buxhetore të krijuara nga NJVQV dhe që presin miratimin nga ana e MF dhe vendosjen e kodit përfundimtar buxhetor. |
| *Projekte të reja për Miratim* | Këtu shfaqen projektet e reja të investimeve të krijuara nga NJVQV në pritje të vendosjes së kodit përfundimtar buxhetor nga MF. |
| *Produkte të reja për Miratim* | Këtu shfaqen produktet e reja buxhetore të krijuara nga NJVQV dhe që presin miratimin nga ana e MF dhe vendosjen e kodit përfundimtar buxhetor. |

**Menyja e MF**

| Emërtimi i Ekranit | Shpjegim i mëtejshëm |
|---|---|
| **Hapja Vitit/Fazës së Re** | Krijimi i ciklit të ri të PBA-së (Viti/Faza). |
| **Faktorët e Modifikimit** | Hedhja në sistem e Faktorëve të Modifikimit të Çmimit për tre vitet e PBA-së. |
| **Transfertat nga Buxheti** | Këtu hidhen ose modifikohen në sistem transfertat e ndryshme nga Buxheti Qendror për NJVQV. |

### *6.2 Konfigurimi i Sistemit nga Administratori*

**KONFIGURIMET**

| Emërtimi i Ekranit | Shpjegim i mëtejshëm |
|---|---|
| **Administrative** | Administratori i Sistemit këtu bën konfigurimin e: Qarqeve, NJVQV, Njësive Administrative, Ministrive të Linjës dhe Degëve të Thesarit. |
| **Buxhetore** | Administratori i Sistemit këtu bën konfigurimin e: Funksioneve Buxhetore, Programeve Buxhetore, Projekteve/Produkteve, Njësive |

| | |
|---|---|
| | Shpenzuese, Grupeve të Llogarive Ekonomike, Llogarive Ekonomike, Burimeve të Financimit, Kategorive të të Ardhurave, Kategorive të Detyrimeve të Prapambetura, Kategorive të Informacioneve Bazë të Bashkive, Kategorive të Informacioneve Bazë të Programeve. |
| **Vitet** | Administratori i Sistemit këtu bën konfigurimin e Viteve dhe Fazave të PBA. |

### *6.3 Administrimi i akesit në SMBV*

**AKSES**

| **Emërtimi i Ekranit** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| **Përdoruesit** | Administratori i SMBV këtu bën menaxhimin e Roleve dhe Përdoruesve të Sistemit. |
| **Regjistri i Aktiviteteve** | Këtu mbahet rregjistri i të gjitha ndërveprimeve me SMBV nga ana e të gjitha përdoruesve të tij. |

### *6.4 Mjedisi i Punës i NJVQV-së*

**PANELI I NJVQV**

| **Emërtimi i Ekranit** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| NJVQV 1 Të dhëna mbi NJVQV | Informacion i përgjithshëm dhe të dhëna statistikore për vitet e fundit të veprimtarisë së NJVQV-së. |
| NJVQV 2 Strukutra Organizative | Informacion se si strukturat e ndryshme menaxheriale apo të menaxhimit të shërbimeve të NJQVQ janë organizuar sipas programeve buxhetore. |
| NJVQV 3 Numri i Punonjësve | Informacion mbi numrin e punonjësve të NJVQV sipas programeve buxhetore, njësive shpenzuese dhe funksioneve të qeverisjes vendore. |
| NJVQV 4 Detyrimet e Prapambetura | Informacion mbi stokun dhe amortizimin e detyrimeve të prapambetura të NJQVQ. |
| NJVQV 5 Njësitë Shpenzuese të NJVQV-së | Informacion mbi njësitë shpenzuese aktive të NJQVQ. |

**PBA**

| **Parashikimi i të Ardhurave** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| Parashikimi i të Ardhurave | Vendosni parashikimin e të ardhurave për tre vitet e ardhshme sipas kategorive dhe burimeve kryesore. Gjithashtu, jepni të njëjtin informacion për vitin aktual (fillestar dhe me ndryshime) si dhe dy vitet e mëparshme. |

| **Specifikimi i Programeve** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| DPP1: Struktura e Programeve | Aktivizoni programet ekzistuese për t'u përdorur për ciklin e ri të PBA ose krijoni programe të reja për menaxhimin e shërbimeve publike. |
| DPP2: Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) | Shtoni anëtarët dhe përcaktoni drejtuesin dhe sekretarin e secilit prej Ekipeve të Menaxhimit të Programit duke siguruar disa të dhëna kontakti për ata. |
| DPP3: Deklarata e Politikës së Programit | Vendosni detajet e programit sipas NJVQV-së në aplikacion. Siguroni informacion mbi qëllimet afatgjata dhe treguesit përkatës të performancës; objektivat afatmesëm dhe treguesit përkatës të performancës; standardet e shërbimeve të orfruara nga programi. |

| **Plani i Shpenzimeve** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| PSHP1 – Alokimi i Buxhetit për Vitin Aktual | Këtu hidhet shpërndarja e buxhetit për vitin aktual (fillestare dhe me ndryshime) dhe dy vitet e kaluara (fakti) sipas programeve të NJVQV-së dhe artikujve buxhetorë. |
| PSHP2 - Tavanet Përgatitore të PBA-së | Këtu hidhen Tavanet Përgatitore të PBA-së për tre vitet e ardhshme fiskale të miratuara nga Këshilli i NJVQV-së sipas grup artikujve buxhetorë. |
| PSHP3 – Alokimi i Tavaneve për Programet | Këtu hidhet shpërndarja e Tavaneve Përgatitore të PBA-së të NJVQV-së sipas programeve dhe grup artikujve buxhetorë për secilin nga tre vitet e ardhshme. |
| PSHP4 – Projektet e Investimeve | Identifikoni projektet ekzistuese të Investimeve ose krijoni projekte të reja |

| | |
|---|---|
| | investimi brenda secilit program buxhetor, duke plotësuar fishën e projektit si dhe duke siguruar disa të dhëna mbi kostot e miratuara dhe historike. Këtu bëhet gjithashtu planifikimi i shpenzimeve të projekteve për tre vitet e ardhshme të PBA-së. |
| PSHP5 - Pema e Programit | Identifikoni produktet për çdo program për çdo vit dhe lidhini ato me objektivat përkatës. Listoni dhe përshkruani aktivitetet që NJVQV-ja duhet të ndërmarrë për të ofruar çdo produkt të programit për çdo vit. Përcaktoni sasitë e produkteve të programit dhe planifikoni shpenzimet e nevojshme për financimin e aktiviteteve për të ofruar produktet e programit. |
| PSHP6 – Miratimi i Planeve të Shpenzimeve | Kur sasitë e produkteve dhe shpenzimet e aktiviteteve për të gjitha produktet hidhen në PSHP5 për një vit të caktuar, kontrolloni që të mos ketë diferenca ndërmjet tavanit të caktuar për programin dhe shpenzimeve të planifikuara të programit (për vitin e caktuar). Nëse diferencat janë zero këtu mund të miratohet plani i shpenzimeve të programit. |
| PSHP7 - Kërkesa Shtesë | Jepni detaje për çdo kërkesë për produkte shtesë apo shpenzime shtesë për produktet ekzistuese. |

**BUXHETI VJETOR**

| **Detajimi i Buxhetit** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| FB1: Detajimi i Buxhetit | Detajoni shpenzimet e produkteve për vitin e parë të PBA (Buxhetin Vjetor) sipas burimit të financimit dhe artikujve buxhetorë. Lidhni çdo produkt me një Njësi Shpenzuese të veçantë, në përputhje me organizimet për ofrimin e produkteve. |
| FB2: Plani i Arkës | Përgatitja e planit mujor të arkës sipas njësive shpenzuese dhe grup artikujve buxhetorë. |
| FB3: Lehtësimet Fiskale | Detajimi i politikave të lehtësimeve fiskale dhe efektet e tyre financiare në buxhet. |
| FB4: Plani i Menaxhimit të Riskut | Detajimi i planit të menaxhimit të riskut. |

| | |
|---|---|
| FB5: Subvencionet | Detajimi i të dhënave kryesore financiare për shoqëritë tregtare në të cilat ka pronësi njësia qeverisëse. |

**MONITORIMI I BUXHETIT**

| **Monitorimi i Buxhetit** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| MB1: | *[për t'u prezantuar në Versionin 2]* |
| MB2: | *[për t'u prezantuar në Versionin 2]* |
| MB3: | *[për t'u prezantuar në Versionin 2]* |
| MB4: | *[për t'u prezantuar në Versionin 2]* |

**RAPORTET**

| **Raportet** | **Shpjegim i mëtejshëm** |
|---|---|
| **Nën-menyja: Raportet e MF-së** | |
| Raporti MF1: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Nivelit I, II dhe III të COFOG. | |
| Raporti MF2: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas kategorive ekonomike | |
| Raporti MF3: Të ardhurat e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Tabelës së të Ardhurave | |
| Raporti MF4: Numri i punonjësve të NJVQV-ve sipas programeve dhe funksioneve qeverisëse | |
| | |
| **Nën-menyja : Raportet e NJVQV-së** | |
| **Raportet e PBA-së** | |
| Raporti PBA1: Tavanet Përgatitore të PBA | |
| Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave | |
| Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik | |
| Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG) | |

| | |
|---|---|
| Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik | |
| Raporti PBA6: Deklarata së Politikës së Programit | |
| Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit | |
| Raporti PBA8: Projektet e Investimeve | |
| Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin | |
| **Raportet e Buxhetit Vjetor** | |
| Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese | |
| Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve | |
| Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave | |
| Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik | |
| Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV | |
| Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore | |
| Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV | |
| Raporti BV8: Efekti Financiar I Përjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale | |
| Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV | |
| Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit | |
| Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura | |
| Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve | |
| Raporti BV13: Lista e Projekteve Koncensionare / PPP | |
| Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike | |
| Raporti BV15: Plani i Arkës | |

**PROFILI**

| Ndihmë | Shpjegim i mëtejshëm |
|---|---|
| Detajet | Shfaq detajet e profilit me të cilin përdoruesi është lidhur në sistem. |

| | |
|---|---|
| Modifiko Profilin | Lejon përdoruesin të ndryshojë detajet e profilit dhe fjalëkalimin e tij. |
| Sesionet | Shfaq detajet e sesionit të SMBV, si dhe mundëson daljen nga të gjitha pajisjet e tjera ku përdoruesi mund të jetë lidhur me sistemin. |
| Google Two Factor Authentication | Aktivizon manyrën e dyfishtë të validimit të përdoruesit në sistem, duke rritur sigurinë me të cilën përdoruesi lidhet me sistemin. |

Të gjitha menytë mund të aksesohen në çdo kohë nga brenda sistemit në varësi të privilegjeve të përdoruesit.

### 7. Zona kryesore e ekranit

Secili prej ekraneve të përdorur për të hedhur të dhëna në SMBV mund të përmbajë një sërë komponentësh të ndryshëm.

| | |
|---|---|
| ⇒ Titujt | Këto janë përshkrime të ekraneve dhe kutive të të dhënave. |
| ⇒ Butonat | Këta janë butona mbi të cilët përdoruesi mund të klikojë për të kryer veprimin e specifikuar në kuti. |
| ⇒ Shënoni kutinë | Një kuti me shënime përdoret për të kontrolluar një artikull, kur klikohet, sistemi vendos a ✓në kuti. |
| ⇒ Menytë me zgjedhje | Kur klikohet shigjeta poshtë, ▼sistemi liston zgjedhjet e mundshme në një meny. Përdoruesi klikon në zgjedhjen e tij dhe sistemi më pas vendos atë zgjedhje dhe çdo të dhënë të lidhur në kutitë e të dhënave të sistemit në ekran. |
| ⇒ Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes përdoren kur ka shumë të dhëna për t'u plotësuar në hapësirën e ekranit. Përdoruesi klikon në dy shigjetat▼ ▲në cilindo skaj të shiritit të lëvizjes ose në shiritin rrëshqitës, për të lëvizur nëpër të dhëna derisa ekrani të shfaqë të dhënat e sakta. |
| ⇒ Kutitë e të dhënave të sistemit | Kutitë e sistemit janë ato ku të dhënat shfaqen nga sistemi. Këto kuti kanë një sfond gri dhe nuk mund të ndryshohen nga përdoruesi. Ata janë atje thjesht për të paraqitur informacionin përkatës në ekran. |
| ⇒ Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Këto kuti shfaqen në ekran me një sfond të bardhë dhe janë vendi ku përdoruesi hedh të dhëna në sistem. |

Përdoruesi duhet të ketë parasysh se disa ekrane kanë një fushë të quajtur "Data e krijimit". Kjo i lejon përdoruesit të mbajë gjurmët e datës së krijimit të çdo regjistrimi me rëndësi të veçantë.

Seksionet e mëposhtme shpjegojnë çdo ekran në detaje. Çdo seksion përmban tre pjesë:

⇒ Një diagram që përmbledh procesin.
⇒ Një shembull i ekranit që përdoruesi do të shohë.
⇒ Një përshkrim i të dhënave që duhet të hidhen në atë ekran.

*7.1 Legjenda e Skemës së Proçesit*

| | |
|---|---|
|  | Kërkohet procedura përgatitore përpara përdorimit të SMBV |
|  | Procesi i kryer nga përdoruesi për SMBV |
|  | Procesi i kryer nga sistemi për SMBV |
|  | Fillimi ose përfundimi i procedurave |
|  | Raporti ose dokumenti i gjeneruar nga sistemi ose si pikënisje e procedurave |
|  | Baza e të dhënave për SMBV që përmban të gjitha të dhënat që lidhen me sistemin |
|  | Përshkrimi i të dhënave të paraqitura nga baza e të dhënave |
|  | Kutia e vendimit që kërkon një përgjigje të vërtetë ose të rreme |
| Yes | Lidhja me pjesën tjetër të procedurave nëse përgjigja në kutinë e vendimit është e vërtetë (Po) |
| No | Lidhja me pjesën tjetër të procedurave nëse përgjigja në kutinë e vendimit është e rreme (Jo) |
| | Lidhja me pjesën tjetër të procedurave sipas drejtimit të shigjetës |
| -------------------- | Ilustron lidhjen midis bazës së të dhënave dhe ekranit |

### 8. Ekranet e hyrjes së të dhënave

Disa formate janë të disponueshme vetëm për administratorët për të ndihmuar në përcaktimin e bazës së të dhënave për sistemin.

Ky seksion detajon paraqitjen e formularëve. Këto janë të ndara në tre grupe kryesore dhe mund të aksesohen përmes tre menyve.

⇒ MF - aksesohet nga menyja e të dhënave bazë

MF1: Hapja Vitit/Fazës së Re
MF2: Faktorët e Modifikimit
MF3: Transfertat nga Buxheti

⇒ Administrative - aksesohet nga menyja KONFIGURIMET

Qarqet
NJVQV
Njësitë Administrative
Ministritë e Linjës
Degët e Thesarit

⇒ Buxhetore - aksesohet nga menyja KONFIGURIMET

Funksionet
Programet
Projektet/Produktet
Njësitë Shpenzuese
Grupet e Llogarive Ekonomike
Llogaritë Ekonomike
Burimet e Fondeve
Kategoritë e të Ardhurave
Kategoritë e Detyrimeve të Prapambetura
Kategoritë e Informacioneve Bazë të NJVQV
Kategoritë e Informacioneve Bazë të Programeve
Kategoritë e Subvencioneve
Kategoritë e Lehtësimeve Fiskale

⇒ Vitet - aksesohet nga menyja KONFIGURIMET

⇒ Paneli i NJVQV - aksesohet nga përdoruesit nga NJVQV

NJVQV1: Të dhëna mbi NJVQV
NJVQV2: Strukutra Organizative
NJVQV3: Numri i Punonjësve
NJVQV4: Detyrimet e Prapambetura

NJVQV5: Njësitë Shpenzuese të NJVQV-së

⇒ PBA - aksesohet nga menytë DPP dhe PSHP

**Parashikimi i të Ardhurave**

**Specifikimet e Programit**

DPP1: Struktura e Programeve
DPP2: Ekipi i Menaxhimit të Programit
DPP3: Deklarata e Politikës (Informacionet Bazë të Programit)

**Plani i Shpenzimeve**

PSHP1: Alokimi i Buxhetit për Vitin Korent
PSHP2: Tavanet Përgatitore të PBA-së
PSHP3: Alokimi i Tavaneve për Programet
PSHP4: Projektet e Investimeve
PSHP5: Pema e Programit
PSHP6: Miratimi i Planeve të Shpenzimeve
PSHP7: Kërkesat Shtesë

⇒ BUXHETI VJETOR

FB1: Detajimi i Buxheti
FB2: Plani i Arkës
FB3: Përjashtimet Fiskale
FB4: Plani i Menaxhimit të Riskut
FB5: Subvencionet

⇒ Monitorimi

*[për t'u specifikuar në Versionin 2 të Manualit]*

⇒ Raportet

## 9. Ministria e Financave (FE)

### *9.1 Hapja Vitit/Fazës së Re*

#### *9.1.1 Lista e Cikleve të PBA (vite/faza) të krijuara në SMBV.*




#### *9.1.2. +Krijo një cikël të ri (Viti/Faza e re)*



### *9.1.3 Statusi i PBA së çdo NJVQV për ciklin e PBA*

Në këtë ekran tregohet statusi i PBA të çdo NJVQV (në proçes, miratuar apo dërguar) si edhe data se kur përmbajtja e PBA ka marrë miratimin përfundimtar nga është miratuar



### *9.2 Faktorët e Modifikimit të Çmimit*

Këto përfaqësojnë përqindjet e ndryshimit të transfertës qeveritare përkundrejt vitit të mëparshëm. Nëse këto faktorë mungojnë, atëhërë SMBV i supozon të barabartë me zero, që do të thotë se transfertat qeveritare për secalin nga tre vitet e PBA do të jenë të njëjta me ato të vitit korent.



### *9.3 Transfertat nga Buxheti*

Në këtë ekran MF hedh informacionin në lidhje me Transfertën e Pakushtëzuar të Përgjithshme dhe Transfertën e Pakushtëzuar Sektoriale. I gjithë informacioni për transfertat për vitin bazë (2024 – Fillestar) hidhet në sistem manualisht nga përdoruesi (ose bëhet import nga tabelat excel). Pas miratimit fillestar, këto vlera mbeten të pandryshuara në sistem.

Në vitin '2023 – Rishikuar' hidhen çdo ndryshim në transfertë që ndodh gjatë kohës së përgatitjes së PBA së vitit/fazës në shqyrtim. Me miratimin e transfertave për vitin '2023 – Fillestar' këto vlera aplikohen si vlera fillestare edhe për vitin '2023 – Rishikuar', të cilat mund të modifikohen përsëri gjatë vitit/fazës të PBA-së.

Për tre vitet e ardhshme të PBA-së, në menynë "Kategoritë e të Ardhurave", përdoruesi MF përcakton për secilin nga zërat e transfertës nëse vlerat për tre vitet e PBA për secilin zë të transfertës do të llogaritet bazuar në Faktorët e Modifikimit të vendosur në MF2, apo nëse informacioni për këto transferta (për të tre vitet e PBA) do të hidhet manualisht në këtë ekran.

Vlerat e llogarituara automatikisht bazuar në Faktorët e Modifikimit janë të vendosura në sfond me ngjyrë gri, ndërsa vlerat e modifikueshme manualisht janë të vendosura në sfond me ngjyrë të bardhë në këtë ekran.

Rradha e veprimeve për hedhjen e informacionit të transertave në SMBV është si më poshtë:

1. Në panelin e administrimit, nën menynë: KONFIGURIMET/Buxhetore/Kategoritë e të Ardhurave, për secilin nga zërat e transfertës përcaktohet se cilat hidhen për çdo vit manualisht nga përdoruesi (p.sh. transferta e pakushtëzuar e përgjithshme) dhe se cilat për secilin nga vitet e PBA llogariten duke aplikuar Faktorët e Modifikimit mbi vlerat respective të këtyre transfertave në vitin bazë (p.sh. transfertat e pakushtëzuara sektoriale). Për zërat që do të hidhen manualisht për cdo vit të PBA, aktivizohet opsioni "Plotësuar nga MF Vjetore" duke plotësuar kutinë përkatëse.
2. Hidhen Faktorët e Modifikimit për secilin nga vitet e PBA, duke përdorur menynë MF/Faktorët e Modifikimit nga paneli I administrimit.
3. Hidhen manualisht (ose duke përdorur funksionin 'Import') informacionet e transfertës për vitin bazë (2023 Fillestar) në përputhje me Tabelën 3 të Ligjit të Buxhetit. Pas ruajtjes së informacioneve të hedhura në SMBV në këtë hap, sistemi llogarit automatikisht, bazuar në Faktorët e Modifikimit dhe vlerat në vitin bazë, vlerat e transfertave që nuk kanë të përzgjedhur opsionin "Plotësuar nga MF Vjetore" për secilin nga tre vitet e PBA.
4. Hidhen manualisht (ose duke përdorur funksionin 'Import') informacionet e transfertës për vitin bazë (2023 Rishikuar) në përputhje me Tabelën 3 të Ligjit të Buxhetit të përditësuar me çdo vendim-marrje që mund të ketë sjellë ndonjë ndryshim në atë tabelë.
5. Hidhen manualisht (ose duke përdorur funksionin 'Import') informacionet për zërat e transfertës që kanë të përzgjedhur opsionin "Plotësuar nga MF Vjetore" në përputhje me Shtojcën 1 të Udhëzimit Vjetor të Përgatitjes së PBA Vendor.


Transfertat nga Qeveria | SMBV
Kategoritë e të Ardhurave | SMBV
https://smbv.fvv.al/management/mtbp/1/show-revenue
Paneli
Lista e PBA të NJVQV-ve
MFE
Hapja Vitit/Fazës së Re
Faktorët e Modifikimit
Transfertat nga Buxheti
KONFIGURIMET
Administrative
Buxhetore
Vitet
AKSES
Përdoruesit
Impersonate
Regjistri i Aktiviteteve
SuperAdmin SMBV
Paneli / PBA / 2024 - Faza 3 (Finale) / Transfertat nga Qeveria
TRANSFERTAT NGA QEVERIA
Vlerat paraqiten në: 000 ALL
2023 - Fillestar
2023 - Fillestar
2023 - Rishikuar
2024
2025
2026
Modifiko Të Ardhurat
Import
Nr.
NJVQV-të
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme
Konviktet e arsimit parauniversitar
Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor
Mbrojtja sociale
Administrimi i pyjeve
Rrugët
Ujitja dhe Kullimi
Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"
Menaxhimi i mbetjeve urbane
Bashkia Belsh
Bashkia Berat
Bashkia Bulqizë
Bashkia Cërrik
Bashkia Delvinë
Bashkia Devoll
Bashkia Dibër
Bashkia Divjakë
Bashkia Dropull
Bashkia Durrës
Bashkia Elbasan
0.00

## 10. Konfigurimet

### *10.1 Administrative*

#### *10.1.1 Qarqet*



### *10.1.2 Entiteti (NJVQV) (Bashkitë dhe Këshillat e Qarkut)*

Në këtë ekran administrohen (krijohet, fshihet, aktivizohet,ç'aktivizohet) entitete e qeverisjes (Bashkitë dhe Këshillat e Qarqeve).




### *10.2.1.* **+Krijo** *një Entitet të ri*



| | |
|---|---|
| Emri – | Emri i Entitetit në Shqip dhe në Anglisht (p.sh. Bashkia e Lezhës, Këshilli i Qarkut Tiranë, etj. |
| Qarku – | Qarku në të cilin ndodhet NJVQV |
| Kodi – | Kodi buxhetor i Entitetit sipas klasifikimit buxhetor. |
| Metodologjia – | Përcaktimi nëse Entiteti po ndjek 'Metodologjinë e Re' të buxhetimit sipas Udhëzimit Nr. 3, datë 28.02.2024 të Ministrisë së Financave; apo po ndjek 'Metodologjinë Ekzistuese' sipas Udhëzimit Nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Financave. |
| Misioni – | Misioni i Entitetit i përcaktuar në krijimin e tij. |
| Shkurtimi – | Një shkurtim i emërtimit të NJVQV që do të përdoret në krijimin e kodeve provizore të produkteve nga ana e NJVQV në fjalë. |
| Adresa – | Adresa zyrtare e NJVQV. |

### *10.1.3 Njësitë Administrative*




| ID | NJVQV | Emri | Kodi | Aktiv |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkia Berat | Berat | | Aktiv |
| 2 | Bashkia Berat | Velabisht | | Aktiv |
| 3 | Bashkia Berat | Otllak | | Aktiv |
| 4 | Bashkia Berat | Sinjë | | Aktiv |
| 5 | Bashkia Berat | Roshnik | | Aktiv |
| 6 | Bashkia Dimal | Ura-Vajgurore | | Aktiv |
| 7 | Bashkia Dimal | Poshnje | | Aktiv |
| 8 | Bashkia Dimal | Kutalli | | Aktiv |
| 9 | Bashkia Dimal | Cukalat | | Aktiv |
| 10 | Bashkia Kuçovë | Kuçovë | | Aktiv |

### *10.1.4 Ministritë e Linjës*



### *10.1.5 Degët e Thesarit (TDO)*



*10.1.6 Njësitë shpenzuese dhe Degët e Thesarit (TDO)*



### *10.2 Buxhetore*

#### *10.2.1 Programi*

*A) Metodologjia e vitit 2018*

Për NJVQV-të që do të vazhdojnë të ndjekin metodologjinë ekzistuese, programet (dhe kodet e tyre) janë të përcaktuara në Udhëzimin e MF-it të Procedurave Standarde për Përgatitjen e PBA-së së NJVQV-së, dhe këto programe janë të njëjta për të gjitha NJVQV-të. Çdo NJVQV mund të përgatisë dhe menaxhojë buxhetin e saj me një strukturë të përbërë nga deri në 20 programe nga kjo listë, sipas hierarkisë së mëposhtme:






B) *Metodologjia e Vitit 2022.*

Për NJVQV-të që ndjekin metodologjinë e re, kodet e programit nuk janë më pjesë e hierarkisë funksionale COFOG (niveli i parë, i dytë ose i tretë) dhe nuk shërbejnë më për raportimin e shpenzimeve funksionale siç operohet (dhe do të vazhdojnë të operohen) në nivelin qendror ose për bashkitë që ndjekin metodologjinë ekzistuese.

(Për dallim nga NJVQV-të që vazhdojnë me metodologjinë ekzistuese) Në NJVQV-të që ndjekin metodologjinë e re, secili program do të ketë një kod specifik (unik) për secilën NJVQV dhe do të ketë një emër unik për secilën NJVQV. Kjo do të thotë se kodi i përdorur nga një NJVQV për një program specifik nuk do të gjendet në asnjë NJVQV tjetër. Kodet programore për NJVQV-të do të vazhdojnë të jenë 5 shifrore (dhe do të vazhdojnë të jenë pjesë e të njëjtit dimension programor të klasifikimit buxhetor si për institucionet qendrore dhe NJVQV-të sipas metodologjisë ekzistuese), por me strukturë të ndryshme nga kodi i programit për NJVQV që ndjekin metodologjinë ekzistuese (dhe pushtetin qendror). Referenca në kodin e funksionit (një referencë që do të përfshihet në kodin e produktit) do të hiqet nga kodi i programit të NJVQV-së dhe do të pasqyrohet një referencë identifikuese për kodin e njësisë qeverisëse.

Dy shifrat e para të kodit të programit të NJVQV-së do të jenë të njëpasnjëshme me shkronja, secila duke marrë vlerat nga A në Z. Ndërkohë, tre shifrat e fundit të kodit të programit do të përmbajnë kodin e entitetit të NJVQV-së. Për shembull, kodi për programin e parë të Bashkisë Korçë do të jetë:

| *Sekuenciale me shkronja* | | *Kodi i NJVQV* | | |
|---|---|---|---|---|
| **A** | **A** | **1** | **2** | **2** |
| *1 (AZ)* | *2 (AZ)* | *3 (0-9)* | *4 (0-9)* | *5 (0-9)* |

Ku, AA është një sekuencial me shkronja, ndërsa 122 është kodi buxhetor për Entitetin Bashkia Korçë. Programi i dytë i Bashkisë Korçë do të ketë kodin AB122, programi i tretë AC122, programi i katërt AD122, e kështu me radhë.

*10.2.2 Burimet e Fondeve*

*A) Nivelet e Burimeve të Fondeve*



### B) *Burimi i Fondeve*




## 10.2.3 *Llogaritë Ekonomike (Kontabël)*

### A) *Struktura e Kodit të Llogarisë*



### *B) Artikujt (Llogaritë Ekonomike)*

#### B.1) Grupet e Artikujve




#### B.2) Artikujt (Llogaritë Ekonomike)




### *10.2.4 (Kodi) Produkti/Projekti*

Projektet dhe produktet do të përdorin të njëjtin dimension 7-shifror të përdorur në SIFQ. Kodi për çdo produkt do të jetë unik dhe do të ketë një emër unik në SIFQ.

Sipas metodologjisë së re, produktet do të shërbejnë edhe si burim informacioni për raportimin e shpenzimeve funksionale në përputhje me COFOG.

Për të raportuar shpenzimet sipas funksioneve të NJVQV-së dhe në bazë të produkteve, kodi i funksionit ( niveli 3[të] i COFOG) me të cilin lidhet produkti do të inkorporohet në kodin e produktit. Çdo produkt do të shoqërohet vetëm me një funksion, ndërsa një ose më shumë produkte nga një ose më shumë programe të ndryshme mund të kontribuojnë në realizimin e një funksioni vendor specifik (niveli 3 i COFOG).

I. **Produktet jo-projekte.** Për produktet jo-projekte, kodi i produktit 7-shifror do të ketë strukturën e mëposhtme siç tregohet në shembull:

| *Gërmë* | *Funksioni vendor (niveli i 3 i COFOG)* | | | *Kombinim sekuencial alfanumerik* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| V | 9 | 1 | 2 | X | X | X |
| *1* | *2 (0-9)* | *3 (0-9)* | *4 (0-9)* | *5 (AZ, 0-9)* | *6 (AZ, 0-9)* | *7 (AZ, 0-9)* |

- ***Shifra 1*** : V për Vendorin.
- ***Shifrat 2-4*** : Këto tre shifra do të përdoren për të kapur informacionin mbi funksionin vendor për raportimin e shpenzimeve sipas funksioneve të NJVQV-së. Brenda këtij blloku prej tre shifrash, për shifrën e parë do të përdoret konventa e mëposhtme: 1 do të përdoret në vend të 01 për Shërbimet e Përgjithshme Publike; 3 do të përdoret në vend të 03 për Rendin dhe Sigurinë Publike; 4 do të përdoret në vend të 04 për Çështjet Ekonomike; 5 do të përdoret në vend të 05 për Mbrojtjen e Mjedisit; 6 do të përdoret në vend të 06 për banim dhe komoditete komunitare; 7 do të përdoret në vend të 07 për Shëndetin; 8 do të përdoret në vend të 08 për Rekreacion, Kulturë dhe Fe; 9 do të përdoret në vend të 09 për arsim; 0 do të përdoret në vend të 10 për Mbrojtjen Sociale. Shifra e fundit e kodit 5-shifror në nivelin e 3 të COFOG do të hiqet.
- ***Shifrat 5-7*** : Këto tre shifra do të jenë një sekuencë alfanumerike, ku çdo shifër merr vlera nga A-Z dhe 0-9.

II. **Projektet.** Sipas metodologjisë së re, projektet do t'u përmbahen kritereve të mëposhtme:

- Projekti do të vazhdojë të trajtohet në të njëjtën mënyrë siç bëhet aktualisht në nivel vendor, që do të thotë se do të kemi një kod unik projekti 7-shifror që do të përfaqësojë gjithashtu produktin unik për çdo projekt.
- Kodi i projektit do të lidhet me një funksion të vetëm vendor (niveli 3 i COFOG).
- Kodi i ri i projektit do të ketë strukturën e mëposhtme:

| *Gërmë* | *Funksioni vendor (niveli i 3 i COFOG)* | | | *Kombinim sekuencial alfanumerik* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| P | 4 | 5 | 2 | X | X | X |
| *1* | *2 (0-9)* | *3 (0-9)* | *4 (0-9)* | *5 (AZ, 0-9)* | *6 (AZ, 0-9)* | *7 (AZ, 0-9)* |

- Siç u vërejt, struktura e kodit të ri të projektit është e njëjtë me strukturën e kodeve të produktit jo-projekt. Dallimi midis një projekti dhe një produkti jo-projekt do të përcaktohet nga shkronja e parë. Shkronja 'V' do të përdoret për produkte jo-projekt, ndërsa shkronja 'P' do të përdoret për projekte.

### *10.2.5 Kategoritë e të Ardhurave*

Në këtë ekran menaxhohen kategoritë e të ardhurave që shfaqen si zëra në Tabelën e Parashikimit të të Ardhurave të NJVQV. Kategoritë e të ardhurave janë organizuar në mënyrë hierarkike dhe janë të modifikueshme.




Disa detaje në lidhje me veçoritë e secilës kategori:

Burimi i Fondeve: Bën përcaktimin e një kategorie të të ardhurave si një burim specifik fondesh për të bërë kontrollet e nevojshme në fazën e planifikimit të shpenzimeve sipas burimit të financimit.

Rendi: Ky është një kod sekuencial që shërben vetëm për organizimin e kategorive dhe nënkategorive të ndryshme të shpenzimeve.

Aktiv: Përcakton nëse një kategori të ardhurash do të shfqaqet ose jo në Tabelën e Parashikimit të të Ardhurave, pa qenë nevoja për ta fshirë atë kategori dhe të dhënat historike të lidhura me të.

Plotësuar nga MF: Këtu përcakohet nëse të dhënat për një kategori të caktuar të të ardhurave të NJVQV do të plotësohen nga MF (p.sh. transferta e pakushtëzuar e përgjithshme) apo do të plotësohet nga NJVQV (p.sh. taksa mbi truallin).

Plotësuar nga MF Vjetore: Këtu përcaktohet nëse për një kategori të ardhurash që plotësohet nga MF, MF do t'i hedhë të dhënat manualisht (ose përmes importit) për secilin vit të PBA (p.sh. transferta e pakushtëzuar e përgjithshme) apo këto vlera do të llogariten bazuar në vitin bazë dhe faktorët e modifikimit të cmimit (p.sh. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale: Arsimi Parauniversitar)

Përjashtuar nga të Ardhurat Totale: Këtu përcaktohet nëse një kategori specifike e të ardhurave do të përjashtohet apo jo nga Tavani i Përgjithshëm i Përgatitjes së PBA (p.sh. Transferta të Kushtëzuara: për funksione të deleguara).

Veprimet: Shiko, Modifiko dhe Fshij nga kategori të ardhurash.

### *10.2.6 Kategoritë e Detyrimeve të Prapambetura*

Në këtë ekran menaxhohen kategoritë e të detyrimeve të prapambetura që shfaqen si zëra në Tabelën e Detyrimeve të Prapambetura të NJVQV. Kategoritë e detyrimeve të prapambetura janë organizuar në mënyrë hierarkike dhe janë të modifikueshme.




Rendi i kategorive të detyrimeve të prapambetura është një sekuencial hierarkik që shërben për organizimin e kategorive të ndryshme në tabelë.

### *10.2.7 Kategoritë e Informacioneve Bazë të NJVQV*

Në këtë ekran menaxhohen kategoritë e Informacioneve Bazë të NJVQV që shfaqen si zëra në Tabelën NJVQV1: Të Dhëna mbi NJVQV. Kategoritë e informacioneve janë organizuar në mënyrë hierarkike dhe janë të modifikueshme.




Disa detaje në lidhje me veçoritë e secilës kategori:

| | |
|---|---|
| NJVQV: | Tregon nëse një kategori e caktuar është specifike për një NJVQV të dhënë, dhe i shfaqet vetëm asaj NJVQV apo nëse është standarde për të gjitha NJVQV. Në rastin e dytë kjo fushë është bosh. |
| Funksioni: | Tregon lidhjen e një kategorie të caktuar informacioni me një funksion vendor. |
| Tipi: | Të Përgjithshme – tregon se kategoria në fjalë përfaqëson të dhëna të përgjithshme; Vjetore – Tregon se për kategorinë në fjalë duhen dhënë informacione historike në vite. |
| Rendi: | Është një sekuencial hierarkik që shërben për organizimin e kategorive të ndryshme në tabelë. |
| Aktiv: | Përcakton nëse një kategori të ardhurash do të shfqaqet ose jo në Tabelën e Informacioneve Bazë të NJVQV, pa qenë nevoja për ta fshirë atë kategori dhe të dhënat historike të lidhura me të. |

*Shënim:* Disa kategori kryesore informacioni janë krijuar nga MF, ndërkohqë që NJVQV kanë mundësi të shtojnë kategori të tjera duke përdorur Ekranin NJVQV1: Informacione Bazë për NJVQV nga Paneli i NJQVQ.

### *10.2.8 Kategoritë e Informacioneve Bazë të Programeve*

Në këtë ekran menaxhohen kategoritë e Informacioneve Bazë të Programit që shfaqen si zëra në Tabelën e Informacioneve Bazë të Programit që është e bashkëlidhur me DPP3: Deklarata e Politikës së Programit. Kategoritë e informacioneve janë organizuar në mënyrë hierarkike dhe janë të modifikueshme.




Disa detaje në lidhje me veçoritë e secilës kategori:

| | |
|---|---|
| NJVQV: | Tregon nëse një kategori e caktuar është specifike për një NJVQV të dhënë, dhe i shfaqet vetëm asaj NJVQV apo nëse është standarde për të gjitha NJVQV. Në rastin e dytë kjo fushë është bosh. |
| Funksioni: | Tregon lidhjen e një kategorie të caktuar informacioni me një funksion vendor. |
| Tipi: | Të Përgjithshme – tregon se kategoria në fjalë përfaqëson të dhëna të përgjithshme; Vjetore – Tregon se për kategorinë në fjalë duhen dhënë informacione historike në vite. |
| Rendi: | Është një sekuencial hierarkik që shërben për organizimin e kategorive të ndryshme në tabelë. |
| Aktiv: | Përcakton nëse një kategori të ardhurash do të shfqaqet ose jo në Tabelën e Informacioneve Bazë të NJVQV, pa qenë nevoja për ta fshirë atë kategori dhe të dhënat historike të lidhura me të. |

| | |
|---|---|
| *Shënim:* | Aktualisht në sistem nuk kemi asnjë kategori informacionesh për programin. Këto pritet të shtohen nga NJVQV duke përdorur . |

## 11. PBA

### *11.1 Parashikimi i të Ardhurave*

Në këtë ekran hidhet informacioni për Parashikimin e të Ardhurave të NJVQV sipas kategorive të caktuara. Informationet në lidhje me transfertat nga qeverisja qendrore (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme, transferta e pakushtëzuar sektoriale apo ndonjë transfertë specifike) hidhen nga MF dhe kalojnë automatikisht në këtë tabelë. Këto janë informacione që nuk mund të editohen nga NJVQV




Disa detaje në lidhje me disa veçori të kësaj tabele:

**Modifiko** – Ky buton shërben për të aktivizuar versionin e modifikueshëm të tabelës me qëllim hedhjen e të dhënave në të.

**Mirato** – Ky buton shërben për të miratuar Parashikimin e të Ardhurave. Pas këtij miratimi, Totali i të Ardhurave (minus vlerat për transfertën e kushtëzuar) për vitin korent dhe tre vitet e ardhshme të PBA kalon tek pasqyra e përgatitjes së Tavaneve Përgatitore të PBA-së.

Në kollonën **"2023[1] (Plani Fillestar i të Ardhurave)"** hidhet nga NJVQV informacioni në lidhje me planin fillestar të të ardhurave të miratuar nga Këshilli i NJVQV si pjesë e buxhetit të vitit 2023. Pas miratimit të ekranit të Parashikimit të të Ardhurave, kjo kollonë mbetet e paeditueshme nga ana e përdoruesit.

Në kollonën **"2023 (Plani i Rishikuar i të Ardhurave)"** hidhet fillimisht plani fillestar i të ardhurave i miratuar nga Këshilli i NJVQV si pjesë e buxhetit të vitit 2023, dhe pastaj cdo ndryshim (shtesë apo pakësim) që ndodh në planin e të ardhurave për ndonjë nga kategoritë e të ardhurave. Përditësimi i kësaj kollone me ndryshimet sa herë që (dhe menjëherë sapo) ndodhin gjatë vitit ushtrimor është

[1] Në këtë rast viti 2023 përfaqëson vitin korent.

shumë i rëndësishëm pasi ky informacion i përditësuar do të reflektohet automatikisht në tabelat e tavaneve si dhe do të shërbejë në proçesin e monitorimit të NJVQV.

**Totali i të Ardhurave** – Informacioni në lidhje me totalin e të ardhurave duhet hedhur manualisht nga ana e përdoruesit.

**Totali i Llogaritur i të Ardhurave** – Ky total llogaritet automatikisht nga sistemi bazuar në vlerat e hedhura për secilën kategori të të ardhurave dhe secilin vit buxhetor. Ky total shërben si element verifikimi të saktësisë së hedhjes së informacionit në tabelë. Nëse Totali i të Ardhurave është i ndryshëm nga Totali i Llogaritur i të Ardhurave për ndonjë nga vitet, atëherë sistemi nuk lejon ruajtjen e informacionit të hedhur në tabelë dhe tregon me kontur të kuq tek rreshti i Totalit të të Ardhurave vitin për të cilin ekzsiton një mospërputhje.

**Ruaj** –Në fund të ekranit të ekranit të Parashikimit të të Ardhurave gjendet butoni **Ruaj** që shërben për ruajtjen në databaë të informacioneve të hedhura në ekran.

## *11.2 Specifikimi i Programeve*

### *11.2.1 DPP1 : Struktura e Programeve*

Hapi i parë në përgatitjen e PBA-së është përcaktimi i strukturës së programeve. Në një farë mase, numri dhe përmbajtja e programeve janë të paracaktuara. Udhëzimi i vitit 2018 për përgatitjen e PBA përcakton numrin dhe kodet për programet e shpenzimeve në NJVQV që ndjekin këtë metodologji.

NJVQV të përfshira në metodologjinë e vitit 2022 për përgatitjen e PBA dhe buxhetit vjetor, po hartojnë një strukturë të re programore që përafrohet me strukturën menaxheriale të ofrimit të shërbimeve publike.

DPP1 përdoret për të hedhur në sistem detajet e programit për secilën NJVQV dhe është detyra e parë që NJVQV-të duhet të ndërmarrin. Ky ekran e çon përdoruesin në dy ekrane të tjera që lidhen me plotësimin e informacionit të programit në sistem: DPP2 dhe DPP3.

A) DPP 1: Skema e procesit



B) DPP 1: Ekrani







C) DPP1: Përshkrimi i të dhënave

| Tipi | Emri në ekran | Përshkrimi i funksionalitetit |
|---|---|---|
| Butonat | Aktivizo Programin | Ky buton kur klikohet hap nje dritare komunikimi për të aktivizuar një program ekzistues ose krijuar një program të ri. |
| | Filtro, Pastro Filtrat | Këto butona përdoren për të filtruar një program të caktuar kur lista e programeve është e gjatë. |
| | Shiko Programit | Ky buton përdoret për të treguar detajet e një programi |
| | Modifiko Programin | Ky buton përdoret për të modifikuar detajet e programit. Pas miratimit të një programi, vetëm përshkrimi i tij mund të modifikohet. |
| | Çaktivizo Programin | Ky buton për të çaktivizuar një program nga lista e programeve të PBA me të cilin po punohet. |
| Menytë me zgjedhje | Shfaq 10 rekorde | Tregon numrin e rekordeve që shfaqen në ekran. Përdoruesi mund të zgjedhë midis 10, 25, 50 apo 100 rekordeve. |
| Shiritat e lëvizjes | Një shirit lëvizës është i disponueshëm pranë përshkrimit të programit për të mundësuar hedhjen dhe shikimin e përshkrimeve të gjata. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe Emri i Entitetit shfaqen automatikisht nga sistemi buzuar në përkatësin e përdoruesit. |
| | Kodi i Programit | Kodi i Programit gjenerohet automatikisht nga sistemi (për NJVQV-të që përdorin metodologjinë ekzistuese) ose do të krijohet automatikisht nga sistemi (për NJVQV-të që përdorin metodologjinë e re). |
| | Emri i Programit | Emri i programit shfaqet automatikisht nga sistemi kur po shfaqim/modifikojmë një program të krijuar më parë. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri i programit (SQ) | Përdoruesi vendos emrin e programit në rastin e bashkive duke përdorur metodologjinë e re. |
| | Emri i programit (EN) | Përdoruesi hedh emrin e programit në anglisht. |
| | Përshkrimi i Programit | Përdoruesi ofron një përshkrim të programit. Duhet të jetë konciz dhe të shpjegojë qartë se çfarë bën/përmban programi. |

### *11.2.2 DPP2: Ekipi i Menaxhmit të Programit (EMP)*

Përgatitja e DPP-së kryhet nga strukturat brenda NJVQV-ve përgjegjëse për programin. Në shumicën e rasteve, strukturat administrative/menaxhimi brenda NJVQV-ve janë të tilla që përgjegjësia për një program specifik të shpenzimeve i takon një drejtorie specifike. Megjithatë, një program shpenzimesh mund të jetë përgjegjësi e shumë drejtorive. Për qëllimin e zbatimit të këtyre procedurave të përgatitjes së PBA-së, Koordinatori i GMS duhet t'i propozojë Kryetarit të GMS-së për miratim një Ekip të Menaxhimit të Programit për çdo program shpenzimesh. Ekipi i Menaxhimit të Programit duhet të përbëhet nga përfaqësues (idealisht Drejtorët) nga çdo Drejtori me një interes të drejtpërdrejtë ose të fortë indirekt në menaxhimin e programit. Kryetari i GMS duhet të emërojë një nga anëtarët e ekipit si Drejtues të Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP) dhe një tjetër si Sekretar të GMS (SEMP).

DPP2 përdoret për të hedhur detaje rreth anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit në SMBV.

A) DPP2: Skema e procesit



## B) DPP2: Ekrani






C) DPP2: Përshkrimi i të dhënave

| Tipi | Emri në ekran | Përshkrimi i veprimit |
|---|---|---|
| Menytë me zgjedhje | Kodi & Emërtimi i Programit | Programi për të cilin do të identifikohet EMP, zgjidhet nga përdoruesi nëpërmjet menysë me zgjedhje. |
| Butonat | Shto Anëtar | Ky buton klikohet për të krijuar një anëtar të ri të Ekipit të Menaxhimit të Programit. |
| | Mirato | Ky buton shërben për të miratuar përbërjet e të gjitha ekipeve të menaxhimit të programeve. |
| | Shiko | Ky buton përdoret për të treguar detajet e një anëtari. |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të modifikuar detajet e një anëtari. |
| | Fshi Antarin | Ky buton përdoret për të fshirë një anëtar të EMP. |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | Programi | Emri i programit përkatës shfaqet nga sistemi. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri | Përdoruesi vendos emrin e anëtarit të EMP në formë. |
| | Mbiemri | Përdoruesi vendos mbiemrin e anëtarit të EMP në tabelë. |
| | Inicialet | Përdoruesi hedh inicialet e anëtarit EMP në tabelë. |
| | Pozicioni në NJVQV | Përdoruesi vendos pozicionin e anëtarit të EMP-së në strukturën e NJVQV-së në tabelë. |
| | Adresa e emailit | Përdoruesi hedh në tabelë adresën e emailit të anëtarit të EMP-së. |
| | Telefoni | Përdoruesi hedh në tabelë numrin e telefonit. |
| Shënoni kutinë | DEMP | Përdoruesi shënon këtë kuti për të treguar se ky person është Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP). |
| | SEMP | Përdoruesi shënon këtë kuti për të treguar se ky person është Sekretari i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP). |

*11.2.3 DPP3: Deklarata e Politikës së Programit*

Përgatitja e Deklaratës së Politikës së Programit është rezultati kryesor i procesit të formulimit/rishikimit të politikës së programit.

Në veçanti, kërkon që çdo NJVQV të rishikojë politikat në lidhje me secilin program të shpenzimeve për të siguruar që një deklaratë e politikës së programit mund të shkruhet (ose rishikohet) për secilin program të shpenzimeve. Deklarata e Politikës së Programit duhet të jetë gjithëpërfshirëse, informuese dhe e dobishme për GMS-në, Këshillin Bashkiak dhe publikun e gjerë. Deklarata e Politikës së Programit do të paraqitet si pjesë e dokumentacionit së PBA-së dhe Buxhetit Vjetor.

Deklarata e Politikës së Programit përbëhet nga këto elementë.

⇒ **Përshkrimi** Përshkrimi i politikës është përkthimi i parimeve të politikave dhe prioriteteve të NJVQV-së në lidhje me programin në hapa për të arritur ndryshimet e dëshiruara.

⇒ **QËLLIMI** Qëllimi i politikës së programit është rezultati i dëshirueshëm dhe i matshëm që duhet të arrihet nëpërmjet veprimeve të programit në një periudhë afatgjatë, që shkon përtej përiudhës së PBA.

- *Treguesit e performancës në lidhje me qëllimin, të cilët janë një mjet ose tregues që përdoret për të vlerësuar ose matur performancën e programit në lidhje me qëllimin dhe standardet e vendosura. Treguesit e performancës zakonisht përcaktohen dhe maten në mënyrë specifike për një periudhë të caktuar kohore. Ato mund të shprehen në forma të ndryshme, të tilla si numra, raporte, përqindje, indekse ose të tjera.*

⇒ **OBJEKTIVI** Objektivat e politikës së programit janë rezultate specifike të matura saktësisht në terma kohorë, sasiorë dhe kostosh, të cilat mund të arrihen brenda një periudhe afatshkurtër deri në afatmesme (3 viteve të PBA-së) dhe shërbejnë si hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës.

- *Treguesit e performancës në lidhje me objektivin janë mjete ose metrikë që përdoren për të vlerësuar ose matur performancën e programit në lidhje me objektivin dhe standardet e vendosura. Treguesit e performancës zakonisht përcaktohen në mënyrë specifike dhe maten për një periudhë të caktuar kohe. Ato mund të shprehen në forma të ndryshme, si numra, raporte, përqindje, indekse ose të tjera.*

⇒ **Standardet** Standardet e politikës së programit janë parametrat sasiorë dhe cilësorë që i japin kuptim politikës. Janë rregullat, udhëzimet dhe parimet që përcaktojnë kriteret dhe metodologjinë për zbatimin dhe ekzekutimin e programit. Këto standarde janë pjesë përbërëse e politikës së programit dhe synojnë të sigurojnë që programi të funksionojë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e përcaktuara.

Ekrani **DPP3: Deklarata e Politikës** përdoret për të hedhur detajet e qëllimeve, objektivave, treguesve të performancës dhe standardeve të politikës së programit.

A) DPP3: Skema e procesit



## B) DPP3: Ekrani






C) DPP3: Përshkrimi i të dhënave

| Tipi | Emri në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Menytë me zgjedhje | Vitet për treguesit e performancës në lidhje me qëllimet | Për çdo tregues të performancës, zgjidhet një vit (përtej 3 viteve të PBA-së) për të cilin është vendosur objektivi për atë tregues të performancës. |
| | Funksioni i Vetëqeverisjes Vendore | Për çdo objektiv duhet përcaktuar funksioni i qeverisjes vendore me të cilin është i lidhur ai. Çdo objektiv mund të lidhet me vetëm një funksion të qeverisjes vendore. |
| Butonat | Shiko | Ky buton përdoret për të shfaqur në ekran detajet e deklaratës së politikës së një programi. |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të modifikuar detajet e deklaratës së politikës së një programi. |
| | Shiko Informacionin Bazë të Programit | Ky buton përdoret për të parë dhe pastaj më tutje për të modifikuar Informationin Bazë të Programit. |
| | Mirato | Ky buton shërben për të miratuar Deklaratën e Politikës së Programit. |
| | Fshij | Kur shfaqet *Deklaratës së Politikës së një Programi*: Ky buton, në varësi të pozicionimit të tij, shërben për të fshirë respektivisht një qëllim, objektiv apo tregues performance të lidhur me to. Kur shfaqet *Lista e Programeve*: Ky buton shërben për të anulluar miratimin e bërë më parë për një deklaratë të politikës së programeve. |
| | + Shto TP | Ky buton shërben për të shtuar një tregues të ri performance. |
| | + Shto Objektiv | Ky buton shërben për të shtuar një objektiv të ri. |
| | + Shto Qëllim | Ky buton shërben për të shtuar një qëllim të ri. |
| | Ruaj | Ky buton shërben për të ruajtur në databasë informacionin e shfaqur në ekran |
| Shiritat e lëvizjes | Një shirit lëvizës aktivizohet pranë çdo kutie përshkrimi për të lejuar hyrjen dhe shikimin e përshkrimeve të gjata, ose për të lundruar nga një regjistrim në tjetrin kur numri i regjistrimeve kërkon më shumë hapësirë se ai i disponueshëm. | |

| | | |
|---|---|---|
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV: | Kodi dhe emërtimi i NJVQV shfaqen automatikisht nga sistemi në përputhje me përkatësinë e përdoruesit të loguar në në sistem. |
| | Programi: | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen automatikisht nga sistemi në përputhje me përkatësinë e përdoruesit të loguar në në sistem. |
| | Përshkrimi i politikës së programit: | Përdoruesi mund të modifikojë përshkrimin e politikës së programit të hedhur në sistem në fazën e aktivizimit/krijimit të programit. |
| | Vlera e TP për Vitin Bazë | Shfaqen automatikisht nga të dhënat e PBA-së së mëparshme. |
| | Vlerat e Synuara të TP për 2 vitet e para të PBA-së | Shfaqen automatikisht nga të dhënat e mëparshme të PBA-së. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | **Qëllimi** i politikës së programit: | Përdoruesi hedh përshkrimin e qëllimit(eve) të politikës së programit. |
| | Tregues Performance të lidhur me qëllimin: | Përdoruesi hedh emrin identifikues të treguesit të performancës të lidhur me qëllimin, njësinë matëse të tij, vlerën për vitin bazë të treguesit të performancës, vitin dhe vlerën e synuar të treguesit të performancës. |
| | Njësia e Matjes (së treguesit të performancës) | Për çdo tregues të performancës, zgjidhet (ose krijohet) një njësi matëse në të cilën shprehet treguesi përkatës. |
| | Vlera (Viti Bazë) | Përdoruesi hedh vlerën e synuar treguesit të performancës për vitin bazë. |
| | Viti & Vlera (Synimi) | Përdoruesi përcakton vitin (nga menyja me zgjedhje) dhe vlerën e synuar për këtë vit të treguesit të performancës të lidhur me qëllimin. |
| | **Objektivi** i politikës së programit: | Përdoruesi hedh përshkrimin e objektivit(ave) të politikës së programit. |
| | Tregues Performancës të lidhur me objektivin: | Përdoruesi vendos emrin e treguesit të performancës në nivel objektivi, vlerën për vitin bazë dhe vlerën e synuar për secilin nga tre vitet e PBA-së. |
| | Njësia e Matjes (së treguesit të performancës) | Për çdo tregues të performancës, zgjidhet (ose krijohet) një njësi matëse në të cilën shprehet treguesi përkatës i performancës i lidhur me objektivin. |

| | |
|---|---|
| Vlera (Viti Bazë) | Përdoruesi hedh vlerën e synuar për vitin bazë të treguesit të performancës të lidhur me objektivin. |
| Viti & Vlera (Synimi) | Përdoruesi hedh vlerën e synuar të treguesit të performancës të lidhur me objektivin për secilin nga të tre vitet e PBA. |
| **Standardet** e politikës së programit | Përdoruesi hedh standardet e politikës së programit. |

## *11.3 Planifikimi i Shpenzimeve*

### *11.3.1 PS1: Alokimi i Buxhetit të Vitit Aktual*

Detyra e parë e Sekretarit të GMS në nisjen e procesit të planifikimit buxhetor është përditësimi i sistemit dhe hedhja e alokimit të buxhetit të vitit aktual në SMBV sipas Programeve dhe Llogarive Ekonomike.

Nëpunësi Autorizues (Koordinator i GMS) duhet t'i japë Sekretarit të GMS (Nëpunësit Zbatues) buxhetin e miratuar nga Këshilli i NJVQV për vitin aktual dhe ta udhëzojë që të hedhin të dhënat në PSHP1.

Me marrjen e buxhetit të vitit aktual nga Koordinatori i GMS, Sekretari i GMS duhet të hedhë alokimet në nivel Artikulli në SMBV për çdo Program duke përdorur ekranin PSHP1.

Sekretari i GMS-së së pari zgjedh Programin nga menyja përkatëse.

Më pas, Sekretari i GMS duhet të hedhë alokimet për programet sipas artikujve dhe totalin e programit në SMBV, duke siguruar që totali i hedhur për artikujt të përputhet me totalin e llogaritur nga SMBV.

Vini re se të dhënat e hedhura mund të ruhen vetëm kur totali i hedhur është i barabartë me totalin e llogaritur.

A) PSHP1: Skema e Proçesit



## B) PSHP1: Ekrani






C) PSHP1: Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimi i Butonit në Ekran | Përshkrimi i funksionalitetit |
|---|---|---|
| Butonat | Shiko | Ky buton përdoret për të shfaqur në ekran alokimin e buxhetit për vitin korent të një programi. |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të alokimit të buxhetit për vitin korent të një programi. |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të alokimit të buxhetit për vitin korent të një programi. |
| | Mirato | Ky buton shërben për të miratuar alokimin e buxhetit për vitin korent të një programi, pasi të jetë verifikuar që alokimet e hedhura në SMBV përputhen me ato të miratuara nga Këshilli i NJVQV. |
| | Mirato | Ky buton shërben për të miratuar alokimin e buxhetit për vitin korent të një programi, pasi të jetë verifikuar që alokimet e hedhura në SMBV përputhen me ato të miratuara nga Këshilli i NJVQV. |
| | Anullo | Ky buton shërben për të anulluar miratimin e bërë më parë për alokimin e buxhetit të vitit korent të një programi. |
| | Ruaj | Ky buton shërben për të ruajtur në databasë informacionin e shfaqur në ekran |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes ndodhen në krahun e djathtë të ekranit në rast se ekrani nuk i shfaq të gjithë artikujt. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i entitetit (NJVQV) shfaqet për përdoruesin. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit, shfaqet për përdoruesin. |
| | Kodi | Kodi i artikullit për të gjithë artikujt e shfaqur, shfaqet nga sistemi. |
| | Artikujt Buxhetorë | Shfaqet emri i artikullit për të gjithë artikujt e shfaqur. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Fakti (t-2)<br>Fakti (t-1)<br>Buxheti Fillestar (t)<br>Buxheti me Ndryshime (t) | Përdoruesi hedh buxhetin për të gjithë artikujt dhe për të gjitha vitet. Për vitet t-1 dhe t-2, të dhënat janë marrë nga raportet e thesarit; për vitin aktual, të dhënat merren nga buxheti fillestar i miratuar nga Këshilli i NJVQV; për Buxhetin me Ndryshime të vitit aktual, të dhënat janë |

| | | |
|---|---|---|
| | | marrë nga raportet e vendimet e Këshillit të NJVQV për ndryshimet e buxhetit. |
| | Totali | Përdoruesi hedh totali për të gjithë vitet si një kontroll saktësie. |
| | Tatli i Llogaritur | Sistemi llogarit automatikisht totalin e vlerave të hedhura për secilin nga vitet. |

*11.3.2 PSHP2: Tavanet Përgatitore të PBA-së*

Detyra e dytë është hedhja e Tavaneve Përgatitore të PBA-së në SMBV për tre vitet e ardhshme fiskale të miratuara nga Këshilli i NJVQV.

Pas marrjes së Tavaneve Përgatitore të PBA-së, Sekretari GMS duhet të hedhë tavanet e NJVQV në SMBV duke përdorur PSHP2.

SMBV ngarkon automatikisht formularin PSHP2 për entitetin përkatës të cilit i përket përdoruesi. SMBV ngarkon automatikisht informacionin për buxhetin e vitit aktual në PSHP2 duke përdorur të dhënat e hedhura në PSHP1.

Më pas, Sekretari GMS duhet të hedhë Tavanet Përgatitore të PBA-së për NJVQV sipas grup artikujve për çdo vit të PBA-së.

A) PSHP2: Skema e Proçesit



## B) PSHP 2: Ekrani



C) PSHP2: Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i funksionalitetit |
|---|---|---|
| Butonat | ✔ Mirato | CGSM klikon këtë buton pasi SGSM ka verifikuar që tavanet paraprake të hedhura në SMBV përputhen me ato të miratuara nga Këshilli Bashkiak. |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të tavaneve përgatitore të PBA. |
| | Ruaj | Ky buton shërben për të ruajtur në databasë informacionin e shfaqur në ekran. |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i entitetit shfaqet për përdoruesin në varësi të përkatësisë së tij. |
| | Totali i llogaritur | Kjo është shuma sipas grup-artikujve, e llogaritur nga SMBV, për vitin aktual dhe 3 vitet e ardhshme, dhe shfaqet si një kontroll saktësie. |
| | Buxheti me Ndryshime (2023) | Të dhënat vijnë nga PSHP1 |
| | Pjesa e Tavaneve Përgatitore të PBA e paalokuar ende | Kjo është diferenca për secilin grup-artikuj midis Tavanit të Përgatitjes së Programit të PBA-së dhe shumës së tavaneve të programit për grupin përkatës të artikujve. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Shpenzime Personeli (600-601) | Tavani i Përgatitjes së PBA-së për paga dhe sigurime për 3 vitet e ardhshme. |
| | Shpenzime të tjera korrente (602-609) | Tavani i përgatitjes së PBA-së për shpenzime të tjera korrente për 3 vitet e ardhshme. |
| | Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232) | Tavani i përgatitjes së PBA-së për Shpenzimet Kapitale të Brendshme për 3 vitet e ardhshme. |
| | Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232) | Tavani i përgatitjes së PBA-së për shpenzimet kapitale të huaja për 3 vitet e ardhshme. |
| | Total | Tavani total për 3 vitet e ardhshme. |

### *11.3.3 PSHP3: Alokimi i Tavaneve për Programet*

Detyra e tretë e përgatitjes së PBA-së është ndarja e Tavanit Përgatitor të PBA-së për programet (të dhënat e buxhetit për vitin aktual sipas programeve janë hedhur paraprakisht në PSHP1.

Tavani i Përgatitjes së PBA-së përfshin katër tavane: Shpenzime Personeli (600 dhe 601); Shpenzime të Tjera Korrente (602-609, 651); Shpenzimet Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661); dhe Shpenzimet Kapitale të Huaja (230-232).

Alokimi i tavaneve për programet bëhet duke u nisur nga tendencat historike të rregulluara me efektet e ndonjë politike/nisme/projekti të ri në kuadrin e programit, apo ndryshimeve strukturore që mund të kenë ndodhur në përbërjen e tij.

Kjo metodë e alokimit synon të sigurojë një pikënisje për procesin e planifikimit të shpenzimeve të programit, e cila do t'i udhëzojë EMP të marrin një vendim përfundimtar për ndarjen e shpenzimeve midis programeve bazuar në objektivat e lidhura me produktet. NJVQV janë të lira të rregullojnë këtë shpërndarje fillestare midis programeve duke siguruar që kufiri total të mos tejkalohet.

Rekomandohet që NJVQV të mos i ndryshojë këto alokime derisa të ndiqen procedurat për të paktën një cikël. Megjithatë, nëse si rezultat i Rishikimit të Politikave të Programit krijohen programe të reja ose eliminohen programet e vjetra gjatë miratimit të buxhetit për vitin aktual, duhet të bëhen rregullime në këtë fazë, duke ruajtur tavanin total.

Ky alokim i tavaneve merr parasysh për secilin vit nevojat për shpenzime të projekteve të investimeve, të cilat nuk kanë shpenzime të rregullta dhe të vazhdueshme nga njëri vit në tjetrin. Për të rregulluar tavanet e programeve në fillim të procesit të planifikimit të shpenzimeve të programit, duhet të ketë informacion shtesë në lidhje me nevojat vjetore për shpenzime të investimeve publike.

SGSM, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Bashkiak për caktimin e tavanit të bazuar në program, duhet të hedhë në SMBV alokimin e tavanit sipas programeve duke përdorur PSHP3.

## A) PSHP3: Skema e procesit



B) PSHP3: Ekrani






C) PSHP3: Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i funksionalitetit |
|---|---|---|
| Butonat |  Shiko | Ky buton përdoret për të shfaqur në ekran alokimin e buxhetit sipas programeve për secilin nga tre vitet e PBA. |
| |  Modifiko | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të alokimit të buxhetit sipas programeve për secilin nga tre vitet e PBA. |
| |  Mirato | Ky buton shërben për të miratuar tavanin e programit për të tre vitet e PBA, pasi të jetë verifikuar që alokimet e hedhura në SMBV përputhen me ato të miratuara nga Këshilli i NJVQV. |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes ndodhen në anën e majtë të ekranit në rast se ekrani nuk i shfaq të gjithë artikujt. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i entitetit shfaqet për përdoruesin, në përputhje me përkatësinë e tij institucionale. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen për përdoruesin, në përputhje me përkatësinë e tij programore. |
| | Krijuar më | Data dhe ora e ruajtjes së këtij alokimi shfaqen automatikisht nga SMBV. |
| | Buxheti me Ndryshime | Buxheti me Ndryshime për vitin aktual për secilin nga 5 grup-artikujt ngarkohet dhe shfaqet në ekran. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Data e krijimit | Përdoruesi hedh informacion mbi datën e krijimit. |
| | PBA [(t+1) - (t+3)] | Përdoruesi hedh tavanin e programit për secilin prej 5 grup-artikujve për secilin nga 3 vitet e PBA-së. |
| | Total | Përdoruesi hedh totalin e tavanit të programit për çdo vit, i cili përdoret nga sistemi për kontrollin e saktësisë. |

*11.3.4 PSHP4: Projektet e Investimeve*

Hapi tjetër është identifikimi i projekteve të investimeve në secilin program. Projektet e investimeve klasifikohen në dy mënyra: projekte investimi me financim të huaj (të cilat mund të përfshijnë edhe financim të brendshëm) dhe projekte investimi me financim të brendshëm.

Projektet e investimeve me financim të huaj përkufizohen si:

⇒ Projektet e investimeve me financim të huaj përfshijnë planifikimin, zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve investuese **që financohen plotësisht ose pjesërisht nga burime të huaja**. Kjo mund të përfshijë kredi, hua, ose ndihmë financiare nga organizata ndërkombëtare, partnerë të huaj, ose institucione tjera financiare. Këto projekte synojnë përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin ekonomik, apo ndonjë qëllim tjetër strategjik në nivelin vendor që do sillte një rritje në asetet e NJVQV.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm përkufizohen si:

⇒ Projektet e investimeve me financim të brendshëm përfshijnë planifikimin, zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve investuese **që financohen tërësisht dhe ekskluzivisht nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore**. Kjo mund të përfshijë burime të tilla si transfertat nga buxheti i shtetit, tatimet, dhe të ardhurat e tjera të NJVQV. Këto projekte synojnë përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin ekonomik, apo ndonjë qëllim tjetër strategjik në nivelin vendor që do sillte një rritje në asetet e NJVQV.

Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP), pas marrjes së udhëzimeve për plotësimin e procedurave të PBA-së, duhet të zhvillojë një takim (ose takime të shumta) me Ekipin e Menaxhimit të Programit (EMP) për të identifikuar projektet e mundshme të investimeve publike që mund të jenë pjesë e programit. Procesi i identifikimit të projekteve duhet të përfshijë projektet që janë aktualisht në zbatim dhe projektet që do të fillojnë gjatë periudhës së PBA-së.

EMP duhet së pari të identifikojë projektet e investimeve publike me financim të huaj. Më pas, EMP duhet të identifikojë projektet e investimeve publike me financim të brendshëm.

Pasi të jenë identifikuar të gjitha projektet, DEMP duhet të plotësojë PSHP4 për çdo projekt duke hedhur të dhëna në kolonat për vitet e mëparshme dhe "shpenzimet totale".

DEMP duhet të kontrollojë për çdo projekt investimi me financim të huaj ose të brendshëm që nuk ka mbishpenzime të planifikuara. Ky kontroll duhet të bëhet duke iu referuar PSHP4.

DEMP duhet të rishikojë ekranin PSHP4 për çdo projekt që nuk ka vlera negative në kolonën për shpenzimet pas periudhës së PBA-së. Fushat në këtë kolonë llogariten nga SMBV. Një shifër negative (e treguar me të kuqe në ekran) tregon se ka një mbishpenzim të planifikuar të shpenzimeve të projektit për një artikull.

Nëse ka shpenzime të tepërta për një projekt, DEMP duhet të konsultohet me EMP-në për të arritur konsensus se si sasia e projektit dhe shpenzimet e aktivitetit duhet të rregullohen për të siguruar që shpenzimet e tepërta të eleminohen.

Kur sasitë dhe shpenzimet e aktivitetit janë hedhur në sistem për të gjitha projektet, duhet të hidhen sasitë e produktit dhe shpenzimet e aktivitetit për produktet "jo projekte".

A) PSHP4: Skema e procesit



B) PSHP4: Ekrani







Shiko Projektin e Investimit | SM
smbv.fvv.al/management/mtbp-e/30/pep4/290/show
Kthehu në Panelin Kryesor
Paneli i NJVQV
PBA
Parashikimi i të Ardhurave
Specifikimi i Programeve
Plani i Shpenzimeve
PSHP1: Buxheti i Vitit Aktual
PSHP2: Tavanet e PBA
PSHP3: Tavanet e Programeve
PSHP4: Projektet e Investimeve
PSHP5: Pema e Programit
PSHP6: Mangësitë në Financimin e Programit
PSHP7: Kërkesat Shtesë
BUXHETI VJETOR
FB1: Detajimi i Buxhetit
FB2: Plani i Arkës
FB3: Lehtësimet Fiskale
AKTIVITETET
Shpenzimet e Vitit 2023
Shpenzimet e Vitit 2024
Shpenzimet e Vitit 2025
Shpenzimet e Vitit 2026
Shto Aktivitet
# Emri Përshkrimi 2023 2024 2025 2026 Veprimet
SHPENZIMET E FISHËS SË PROJEKTIT
Modifiko
NJVQV 127 - Bashkia Lezhë
Programi AD127 - Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet Publike
Projekti P452LE1 - Rehabilitimi i rrjetit rrugor rural
Njësia e Matjes Km
Vlerat paraqiten në: 000 ALL
ARTIKUJT BUXHETORË
FAKTI TË MËPARSHME
FAKTI 2021
FAKTI 2022
BUXHETI 2023
PLANI 2024
PLANI 2025
PLANI 2026
MBETUR 2027 +
SHPENZIMET TOTALE
SHPENZIME KAPITALE TË BRENDSHME (230-232, 255, 1661)
230 Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara
231 Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
232 Shpenzime transferimet kapitale
255 Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme
TOTALI
TOTALI I LLOGARITUR
0.000
© 2024 - SMBV - Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor - Zhvilluar me mbështetjen e


Shpenzimet e Fishës së Projekti
smbv.fvv.al/management/mtbp-e/30/pep4/290/expenses/create-or-edit
PBA 2024 - 2026 | FAZA 3 (FINALE) | 127 - BASHKIA LEZHË
SuperAdmin SMBV
Paneli / PSHP4: Projekti i Investimit / Shpenzimet e Fishës së Projektit
Shpenzimet e Fishës së Projektit
NJVQV 127 - Bashkia Lezhë
Programi AD127 - Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet Publike
Projekti P452LE1 - Rehabilitimi i rrjetit rrugor rural
Njësia e Matjes Km
Vlerat paraqiten në: 000 ALL
ARTIKUJT BUXHETORË
FAKTI TË MËPARSHME
FAKTI 2021
FAKTI 2022
BUXHETI 2023
PLANI 2024
PLANI 2025
PLANI 2026
MBETUR 2027 +
SHPENZIMET TOTALE
SHPENZIME KAPITALE TË BRENDSHME (230-232, 255, 1661)
230 Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara
231 Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
232 Shpenzime transferimet kapitale
255 Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme
TOTALI
TOTALI I LLOGARITUR
0.000
Ruaj
© 2024 - SMBV - Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor - Zhvilluar me mbështetjen e

C) PSHP4: Përshkrimi i të dhënave

| **Titujt** | **Emërtimet në Ekran** | **Përshkrimi i funksionalitetit** |
|---|---|---|
| Butonat | + Aktivizo Projektin | Ky buton shërben për të aktivizuar një projekt të krijuar në ciklet e mëparshme të përgatitjes së PBA ose për të krijuar një projekt të ri. |
| | + Shto Shpenzimet | Ky buton të adreson në ekranin e hedhjes së shpenzimeve të projektit. Këto shpenzime mund të hidhen në nivel projekti ose nivel aktiviteti në varësi të zgjedhjes së përdoruesit. |
| | ✔ Mirato | Ky buton të adreson tek ekrani PSHP6 për kontrollin e mangësive në financim dhe miratimin e planit të shpenzimeve të programit. |
| | Shiko | Ky buton përdoret për të shfaqur informacionin e fishës së projektit dhe pastaj më tutje për hedhjen e kostos totale dhe atyre historike të projektit. Nga ekrani që hapet menaxhohet krijimi i aktiviteteve të projektit përmes + Shto Aktivitet dhe hedhja e shpenzimeve në nivel aktiviteti përmes + Shpenzimet e Vitit 2023 . |
| | Modifiko | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të fishës së projektit. |
| | Modifiko Projektin e Investimit | Ky buton përdoret për të hapur ekranin për modifikimin e detajeve të fishës së projektit. |
| | Fshij Projektin e Investimeve | Ky buton shërben për të fshirë një projekt të krijuar më parë. Pas fshirjes, projekti mund të riaktivizohet përsëri, vetëm se të gjitha informationet e hedhura më parë kanë humbur dhe do të duhet të hidhen sërish në SMBV. |
| | Fshi Projektin e Investimit | Ky buton shërben për të fshirë një projekt të krijuar më parë. Pas fshirjes, projekti mund të riaktivizohet përsëri, vetëm se të gjitha informationet e hedhura më parë kanë humbur dhe do të duhet të hidhen sërish në SMBV. |
| | Ruaj | Ky buton shërben për të ruajtur në databasë informacionin e shfaqur në ekran. |

| | | |
|---|---|---|
| Menytë me zgjedhje | | |
| | 2023 Vitet Fiskale | Ky buton shfaqen një listë të vitit korent dhe tre viteve të ardhshme të PBA nga të cilat duhet zgjedhur viti në të cilin do të zbatohet projekti. Nëse projekti do të vazhdojë më gjatë se një vit, viti tjetër mund të shtohet duke përdorur butonin + . |
| | Zgjidh Tipin e Projektit<br>Tipi i Projektit | Një meny me zgjedhje me dy opsione për llojin e projektit: financim i huaj ose financim i brendshëm. |
| | Zgjidh Funksionin e Qeverisjes Vendore<br>Funksioni i Qeverisjes Vendore | Një meny me zgjedhje nga e cila duhet zgjedhur funksioni vendur me të cilin është i lidhur Projekti. |
| | Rrëshen<br>Njësitë Administrative | Një seri menysh me zgjedhje të përdorura për të identifikuar se ku është zbatuar projekti. Përdoruesi mund të zgjedhë më shumë se një njësi administrative duke përdorur butonin + . |
| | 011 - Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme<br>Burimet e Fondeve | Një seri menysh me zgjedhje të përdoura për të identifikuar burimin e financimit të proektit. Nëse projekti financohet nga më shumë se një burim financimi, atëherë ai mund të shtohet duke përdorur butonin + . |
| Shiritat e lëvizjes | Njësitë Administrative, Burimet e Financimit, Funksioni Qeverisjes Vendore Objektivi kanë shirita lëvizës në rast se të gjitha të dhënat nuk mund të shfaqen në ekran në të njëjtën kohë. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i entitetit të qeverisjes vendore shfaqen për përdoruesin automatikisht në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen për përdoruesin automatikisht në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Kodi i projektit | Kodi i projektit përbëhet nga prefiksi "P", identifikuesi i funksionit dhe një identifikues vijues i krijuar nga SMBV. Ky krijohet automatikisht nga SMBV bazuar në funksionin dhe NJVQV e zgjedhur. |
| | Buxheti [Viti Aktual] | Sistemi shfaq buxhetin për çdo artikull të projektit sic është hedhur duke përdorur komandën + Shto Shpenzimet apo |

| | | |
|---|---|---|
| | | + Shpenzimet e Vitit 2023 sipas nivelit të planifikimit të përdorur. |
| | PLANI [t+1] PLANI [t+2] PLANI [t+3] | Sistemi shfaq shpenzimet për çdo artikull për periudhën 3-vjeçare të PBA-së sic është hedhur duke përdorur komandën + Shto Shpenzimet apo + Shpenzimet e Vitit 2023 sipas nivelit të planifikimit të përdorur. |
| | MBETUR [t+4]+ | Sistemi llogarit të gjitha shpenzimet e mbetura për çdo artikull përtej periudhës së PBA-së, si diferencë midis SHPENZIMET TOTALE dhe shumës së shpenzimeve të planifikuara për katër vitet e PBA dhe shpenzimeve faktike në periudhat e mëparshme. |
| Shënoni kutinë | Koncesion | Përdoruesi shënon këtë kuti për të treguar se ky projekt është një koncesion ose PPP. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri i Projektit (SQ) | Emri i projektit në shqip. |
| | Emri i Projektit (EN) | Emri i projektit në anglisht. |
| | Njësia e Matjes | Emri i Njësisë Matëse për Projektin, në mënyrë të ngjashme me produktin, p.sh., kilometra rrugë të ndërtuara, numër klasash të ndërtuara, metër katror gjelbërim i rehabilituar, etj. |
| | Nga data | Shënohet data e fillimit të projektit. |
| | Në datën | Shënohet data e përfundimit të projektit. |
| | Faktike të Mëparshme[2]; Fakti [t-2], Fakti [t-1] | Përdoruesi hedh shpenzimet faktike për çdo artikull buxhetor për 2 vjet para vitit aktual dhe të gjitha shpenzimet e tjera të mëparshme. |
| | Shpenzimet Totale | Përdoruesi hedh Koston Totale për projektin për çdo artikull. |

[2] Faktike të Mëparshme – Përmbledh të gjitha shpenzimet faktike për vitet (t-3) dhe më herët.

*11.3.5 PSHP5: Pema e programit*

**Produktet**

Hapi tjetër në planifikimin e shpenzimeve të programit është identifikimi i produkteve për çdo program dhe për çdo vit. Fokusimi në produktet, në mënyrën se si paraqitet informacioni buxhetor, është një nga objektivat kryesore të PBA-së.

Produktet e programit janë paraqitur në Ekranin 5 të Planifikimit të Shpenzimeve të Programit (PSHP5). Ky ekran kërkon që EMP të identifikojë produktet (shërbimet publike) që programi do të lëvrojë çdo vit dhe të shpjegojë se si këto produkte do të kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe qëllimeve të programit.

DEMP duhet të mbajë një takim (ose takime të shumta) me Ekipin e Menaxhimit të Programit (EMP) për të identifikuar produktet që duhet të realizohen nga programi në çdo vit.

EMP duhet të diskutojë, të konsultohet me stafin teknik aty ku është e nevojshme, dhe të kërkojë marrëveshje ose konsensus mbi produktet që ofron programi dhe se si ato kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe qëllimeve të programit.

Informacioni për produktet e programit do të paraqitet në dokumentin e PBA-së dhe në dokumentacionin e Buxhetit Vjetor. Për të qenë i dobishëm dhe i kuptueshëm, produkti duhet të plotësojë kërkesat "SMART". Produktet SMART përkufizohen si ato që janë:

| | |
|---|---|
| ⇒ **S** pecifike | Kërkon që produkti të jetë i dallueshëm nga produktet e tjera. Produkti duhet të përcaktohet qartë. Produkti duhet të identifikojë me saktësi se çfarë do të ofrohet dhe cilat objektiva specifike duhet të arrihen. |
| ⇒ **M** atshëm | Kërkon që produkti të jetë i matshëm për sa i përket sasisë dhe cilësisë. Produkti duhet të jetë i matshëm në mënyrë që progresi dhe suksesi i produktit ose shërbimit publik të mund të vlerësohet. |
| ⇒ **A** arritshëm | Produkti duhet të jetë i arritshëm dhe i realizueshëm. Do të thotë që njësia ekonomike verifikon ose kontrollon faktorët fizikë të jashtëm që ndikojnë në arritjen e produktit, ose ka besim se veprime të tjera (të ndërmarra nga sektori publik dhe/ose privat) do të sigurojnë që faktorët e jashtëm të mos pengojnë arritjen e produktit. . Ato duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në burimet dhe aftësitë reale në dispozicion për të realizuar produktin ose shërbimin publik. |
| ⇒ **R** ëndësishëm | Produktet duhet të jenë të rëndësishëm dhe domethënës për objektivat dhe nevojat publike. Ato duhet të lidhen me sfidat dhe nevojat e komunitetit ose përdoruesve të synuar. |
| ⇒ **T** erma kohë | Produktet duhet të kenë një kornizë kohore të përcaktuar për realizimin e tyre. Vendosja e një afati të qartë ndihmon në organizimin e aktiviteteve dhe fokusimin e përpjekjeve për të ofruar produktin ose shërbimin publik brenda një periudhe kohore specifike. |

Në këtë fazë të procesit të planifikimit të shpenzimeve të programit, EMP duhet të jetë në gjendje të përshkruajë produktin në terma SMART.

PSHP5 kërkon identifikimin e produkteve, që nënkupton dhënien e emrit, njësisë matëse, përshkrimit, dhe vitet gjatë të cilave do të realizohet. Ai gjithashtu kërkon një shpjegim se si produkti do të kontribuojë në arritjen e objektivave të politikave të programit, duke bërë lidhjen e tij me një objektiv specifik.

Informacioni rreth një produkti në PSHP5 është i lidhur me vitin. Shpesh, pasi të përcaktohet një produkt për një program, ai do të vazhdojë nga viti në vit. Sasia e produktit mund të ndryshojë nga viti në vit, por karakteristikat thelbësore të produktit shpesh do të mbeten të pandryshuara. Megjithatë, ndërsa programet evoluojnë me kalimin e kohës, mund të ketë ndryshime në produktet e programit. Për shembull, ndryshimet në standardet e politikave mund të kërkojnë një lloj produkti të ndryshëm dhe si rezultat, produkti fillestar mund të mos jetë i arritshëm ose duhet të realizohen produkte të reja.

Përpara hedhjes së produkteve për çdo vit, SMBV i lejon përdoruesit të tregojnë nëse produktet nga vitet e mëparshme do të vazhdojnë apo do të ndërpriten. Përdoruesit e bëjnë këtë duke treguar nëse produktet janë aktive ose joaktive. Çdo vit, sistemi shfaq të gjitha produktet aktive dhe joaktive, kështu që është e mundur të riaktivizohen produktet që ishin joaktive më parë.

Gjatë krijimit të produkteve të reja, përdoruesi duhet të specifikojë funksionin vendor me të cilin është i lidhur produkti, dhe bazuar në këtë lidhje, kodi i produktit përcaktohet automatikisht nga SMBV në përputhje me metodologjinë e miratuar në vitin 2022.

Sapo EMP-ja të arrijë konsensusin mbi emrat dhe përshkrimet e produkteve të programit dhe mënyrën se si produktet do të kontribuojnë në objektivat e politikës, DEMP duhet të aktivizojë produktet që do të realizohen në vitin përkatës, të çaktivizojë produktet që nuk do të ofrohen më dhe të hedhë informacionin në lidhje me produktet e reja (funksioni, emri, përshkrimi, njësia matëse, kontributi i produktit në objektivat e politikave të programit) në seksionet përkatëse të PSHP5.

**Aktivitetet**

MF kërkon raportimin e planeve të shpenzimeve të programeve në nivel produkti. Megjithatë, për qëllimet e tyre menaxheriale dhe për të mundësuar lidhjen me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, NJVQV mund të vendosin të realizojnë planifikimin e shpenzimeve të programit në nivelin e aktivitetit, gjë e cila mundësohet edhe nga SMBV. Ekranet e SMBV dhe hapat që duhen ndjekur në këtë rast shpjegohen në Shtojcën 1 të këtij Manuali.

**Vendim-marrja për zgjedhjen e mënyrës së planifikimit të shpenzimeve në nivel produkti apo në nivel aktiviteti duhet të realizohet përpara fillimit të punës me ekranet PSHP4 dhe PSHP5 të SMBV.**

## A) PSHP5: Skema e procesit



B) PSHP5: Ekrani

B.1) PSHP5: Pema e Programit



B.2) PSHP5 - Ekrani i Produktit të ri



B.3) PSHP5: Zgjedhja e produktit të programit



C) PSHP5: Përshkrimi i të dhënave: Produktet

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Menytë me zgjedhje |   Programi | Programi për të cilin do të punohet pema zgjidhet nga një meny me zgjedhje ku identifikohet kodi dhe emërtimi i programit. |
| |  Menaxhimi i Produktit | Kjo meny me zgjedhje përmbledh disa veprime për menaxhimin e produktit:   Përdoret për të krijuar një aktivitet nën produktin e zgjedhur.   Përdoret për të hapur ekranin "Shpenzimet e Aktivitetit" për hedhjen e sasisë dhe shpenzimeve të produktit.   Përdoret për të modifikuar detajet e produktit.   Përdoret për të fshirë produktin e zgjedhur. Me këtë veprim fshihen edhe aktivitetet dhe shpenzimet e hedhura për to. |
| |   Funksioni i Qeverisjes Vendore | Në ekranin që hapet për krijimin e një produkti të ri, kjo meny me zgjedhje shërben për të zgjedhur funksionin e qeverisjes vendore me të cilin është i lidhur produkti. |
| |   Objektivi | Në ekranin që hapet për krijimin e një produkti të ri, kjo meny me zgjedhje shërben për të zgjedhur objektivin e politikës së programit tek i cili kontribuon produkti i krijuar. |
| Shënoni kutinë |   Viti fiskal | Përdoruesi shënon këtë kuti për të treguar se ky produkt (apo aktivitet, sipas rastit) do të realizohet në vitin në fjalë. |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes ndodhen në anën e djathtë dhe në fund të ekranit, si dhe pranë përshkrimit të produktit, në rast se informacioni nuk mund të shfaqet në ekran njëkohësisht. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe Emërtimi i entitetit shfaqen nga sistemi në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen nga sistemi në varësi të përkatësisë programore të përdoruesit. |
| | Kodi i Produktit | Çdo produkti të ri që krijohet i caktohet një kod automatik nga sistemi, bazuar në funksionin që i përket dhe NJVQV që e ka krijuar. |

| | | |
|---|---|---|
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri i Produktit (SQ) | Emri i produktit në shqip. |
| | Emri i Produktit (EN) | Emri i produktit në anglisht. |
| | Përshkrimi i Produktit: | Përshkrim i shkurtër i produktit, duke theksuar shërbimet që do të gjenerohen nga aktivitetet përkatëse të produktit dhe programit dhe qe do të ndihmojë në llogaritjen e kostos së produktit. |
| | Njësia e Matjes | Emri i Njësisë Matëse për Produktin, p.sh., tonelata mbetje, hektarë tokë të ujitur, kilometra rrugë të mirëmbajtura, etj. |

### *11.3.6 Planifikimi i Sasisë dhe Shpenzimeve të Produktit*

Pas identifikimit të produkteve të programit, EMP duhet të përcaktojë objektivat sasiore për produktet e programit dhe të identifikojë shpenzimet e nevojshme për realizimin e tyre. Sasitë e planifikuara dhe shpenzimet e produkteve janë paraqitur në ekranin Shpenzimet e Produktit. Ky ekran aktivizohet duke klikuar në ikonën në cepin e produktit për të cilin do të planifikohen shpenzimet, dhe duke zgjedhur opsionin 'Shto Shpenzimet', komandë e cila aktivizon ekranin e mëposhtëm.




Ekrani i ri që hapet kërkon që Ekipi i Menaxhimit të Programit të përcaktojë sasinë e produktit dhe të identifikojë shpenzimet për secilin produkt për secilin vit.

DEMP duhet të thërrasë një takim të EMP-së për të arritur marrëveshje ose konsensus mbi sasitë e produkteve të programit dhe kërkesat për shpenzime (në nivelin e shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë) për produktet e programit për secilin vit.

Kur është arritur konsensusi ose marrëveshja e EMP mbi sasinë e produktit dhe shpenzimet përkatëse për njwrin vit për çdo produkt të programit, DEMP duhet të hedhë në ekranin e mësipërm:

⇒ Sasitë e planifikuara për produktet
⇒ Shpenzimet për çdo produkt, sipas artikujve buxhetorë

Sasia e produktit dhe shpenzimet e tij duhet të hidhen për çdo produkt me radhë.

A) Skema e procesit



B) Ekrani

B.1) Shpenzimet e Produktit - Planifikimi i shpenzimeve në nivel produkti



C) Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes janë të disponueshme në të djathtë, në rast se informacioni nuk përshtatet i gjithi në ekran. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i NJVQV shfaqen automatikisht nga sistemi në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i Programit shfaqen automatikisht nga sistemi në varësi të përkatësisë programore të përdoruesit. |
| | Produkti | Kodi dhe emërtimi i Produktit të zgjedhur për planifikimin e shpenzimeve shfaqen automatikisht nga sistemi. |
| | Njësia e matjes | Emri i njësisë matëse të produktit, p.sh., hektarë, kilometra, etj. |
| | Shpenzimet për Njësi | Shpenzimet për njësi produkti si raport midis totalit të shpenzimeve të produktit dhe sasisë së produktit për vitin e dhënë. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Sasia | Sasia e produktit që do të realizohet gjatë vitit në fjalë. |
| | Shpenzimet e produktit | Shpenzimet sipas artikujve për çdo produkt për vitin e dhënë, kur planifikimi i shpenzimeve bëhet në nivel produkti. |

*11.3.6 PSHP6: Mangësitë e financimit të programit dhe Miratimi*

Kur sasitë e produktit dhe shpenzimet e aktivitetit për të gjitha produktet regjistrohen në PSHP5 (‘Shpenzimet e Aktivitetit’ ose ‘Shpenzimet e Produktit’, në varësi të nivelit të zgjedhur për bërjen e planifikimit të shpenzimeve) për vitin e caktuar, DEMP duhet të kontrollojë që nuk ka diferenca midis Buxhetit me Ndryshime për programin (për vitin korent) ose alokimit të tavanit për programin (për vitet e PBA) dhe shpenzimeve totale të aktiviteteve (ose produkteve) sipas artikujve buxhetorë për programin. Ky kontroll duhet të bëhet duke përdorur ekranin PSHP6 të SMBV. Çdo ndryshim do të shfaqet si një mangësi financimi i programit në PSHP6.

Për vitin aktual fiskal, PSHP6 tregon Buxhetin me Ndryshime dhe e krahason atë me totalin përkatës të të gjitha shpenzimeve të aktiviteteve për produktet e programit të përcaktuara në PSHP5. Sipas përkufizimit, asnjë mangësi financimi i programit nuk mund të ekzistojë për vitin bazë (dmth. vitin buxhetor aktual). Prandaj, “Mangësitë në Financimit e Programit” për vitin aktual duhet të jetë **zero** për secilin prej artikujve buxhetorë.  Kjo vepron si një kontroll i qëndrueshmërisë për të dhënat e hedhura në SMBV për vitin e parë përkundrejt Vendimeve të Këshillit Bashkiak për buxhetin e vitit aktual.

Gjatë identifikimit të shpenzimeve të aktiviteteve për produktet e programit për vitin aktual, ekziston mundësia e mospërputhjes me buxhetin për shkakt të llogaritjeve të gabuara dhe/apo për shkakt të gabimeve në hedhjen e të dhënave. Që kjo të shmanget, DEMP-ja duhet të kontrollojë që PSHP6 për vitin korent të mos shfaqë diferenca ndërmjet buxhetit me ndryshime për programin dhe detajeve të shpenzimeve të hedhura në PSHP5 për vitin aktual fiskal.

Nëse ndonjë vlerë në kolonën e mangësive të financimit të programit në PSHP6 është jo zero, ka një mangësi në financimin e programit.

DEMP duhet të printojë ekranin PSHP6 dhe të shpërndajë kopje në EMP. Një vlerë jo zero në vitin e parë (dmth. vitin buxhetor aktual) do të thotë se ka një gabim dhe kjo duhet korrigjuar për t'u përshtatur me buxhetin me ndryshime. Një diferencë negative për vitet e nënciklit të mëpasshëm (dmth për vitet e PBA-së) tregon se shpenzimet e planifikuara tejkalojnë tavanin e programit dhe duhet të reduktohen. Një diferencë pozitive për një vit të PBA-së tregon se një pjesë e tavanit të programit nuk është “shpenzuar”.

Mangësitë në financimin e programit duhet të jenë zero (për çdo artikull buxhetorë për vitin aktual; dhe për çdo grup-artikujsh buxhetorë, për vitet e PBA) me qëllim që të lejohet miratimi i planeve të shpenzimeve të programeve.

Kur këto mangësi janë zero, DEMP duhet të klikojë në ‘Mirato’ për të miratuar planin e shpenzimeve të një viti të dhënë dhe pastaj të vazhdojë me vitet e tjera.

A) PSHP6: Skema e procesit



B) PSHP6: Ekrani



C) PSHP6: Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimet në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Butonat |  | Ky buton mundëson përdoruesin të miratojë planin e shpenzimeve të programit për vitin e dhënë. Ai mund të ekzekutohet me sukses vetëm nëse qelizat në kolonën “Mangësitë në Financimin e Programit” janë të gjitha zero. |
| Menytë me zgjedhje | Programi | Kodi dhe emërtimi i Programit zgjidhet nga një meny me zgjedhje. |
| | Viti | Viti për të cilin do të bëhet miratimi i planit të shpenzimeve, zgjidhet nga kjo meny me zgjedhje. |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes ndodhen në të djathtë të ekranit në rast se informacioni nuk përshtatet plotësisht në ekran. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi i emërtimi i NJVQV shfaqen për përdoruesin në varësi të përkatësisë së tij institucionale. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen në ekran në varësi të përkatësisë programore të përdoruesit. |
| | Viti | Viti shfaqet në ekran në varësi të zgjedhjes së bërë për të në menynë përkatëse me zgjedhje. |
| | Artikuj | Shfaqen artikujt buxhetorë dhe grup-artikujt nga klasifikimi i buxhetit. |
| | Shpenzimet e programit | Shpenzimet e planifikuara për programin në PSHP5 shfaqen automatikisht. |
| | Buxheti i Programit/Tavani | Buxheti me ndryshime për vitin korent dhe tavanet vjetore të PBA-së shfaqen nga sistemi. |
| | Mangësitë e financimit të programit | Të dhënat në këtë kolonë llogariten nga SMBV si diferencë ndërmjet Buxhetit/Tavanit të Programit dhe Shpenzimeve të Programit. Kur shpenzimet e planifikuara janë më të vogla se tavani i programit, diferenca paraqitet si një numër pozitiv. Diferencat pozitive të financimit shfaqen me ngjyrë jeshile në sfondin e gjelbër. Kur shpenzimet e planifikuara tejkalojnë tavanin për |

| | | |
|---|---|---|
| | | këtë program, diferenca paraqitet si numër negativ. Diferencat negative të financimit shfaqen me ngjyrë të Kuqe në sfondin e rozë të ekranit. |
| | Mangësitë në përqindje | Të dhënat e regjistruara në këtë kolonë llogariten nga SMBV si diferencë në përqindje ndërmjet buxhetit/tavanit të programit dhe shpenzimeve të programit. |

*11.3.7 PSHP7 – Kërkesa shtesë për PBA*

Kërkesat shtesë të PBA-së paraqiten në ekranin PSHP7. Ky ekran përdoret për të hedhur informacione rreth kërkesave shtesë të programit, të ndara sipas produkteve dhe artikujve, për çdo vit të ciklit të PBA-së.

DEMP-ja duhet të thërrasë një mbledhje të EMP-së për të arritur marrëveshje ose konsensus mbi kërkesat shtesë të PBA-së për programin, duke përfshirë sasitë shtesë të produkteve dhe arsyet e kërkesës shtesë në nivel artikulli të shpenzimeve për secilin prej viteve.

Kur është arritur konsensusi ose marrëveshja e EMP-së për sasitë shtesë të produktit dhe shpenzimet shtesë të shoqëruara për vitin në fjalë për secilin produkt të programit, DEMP duhet t'i hedhë këto në PSHP7.

Sasitë shtesë të produktit dhe shpenzimet shtesë sipas artikujve buxhetorë duhet të hidhen për çdo produkt për vitin në fjalë.

Kur Këshilli i NJVQV të ketë miratuar kërkesën shtesë, Koordinatori GMS, pas marrjes së një raporti të nënshkruar të kërkesës shtesë të PBA-së nga Sekretari i GMS, duhet të tregojë në PSHP7 se Këshilli NJVQV e ka miratuar kërkesën duke klikuar në butonin "Mirato" për çdo program.

A) PSHP7: Skema e procesit



B) PSHP7: Ekrani



C) PSHP7: Përshkrmi i të Dhënave

| **Titujt** | **PSHP10** | **Emri i ekranit** |
|---|---|---|
| | **Kërkesa shtesë të PBA-së** | **Titulli i ekranit** |
| Butonat | Mirato | Përdoruesi klikon këtë buton pasi të jenë miratuar kërkesat shtesë. |
| Menytë me zgjedhje | Kodi i Programit ▼ | Kodi i klasifikimit të buxhetit për Programin zgjidhet nga një meny me zgjedhje. |
| | Viti Fiskal | Zgjidhni vitin nga një meny me zgjedhje. |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes janë të disponueshme në pjesën e sipërme të Outputeve dhe pranë listave të artikujve në rast se nuk përshtaten të gjithë në ekran. Një shirit lëvizës është gjithashtu i disponueshëm pranë kutive të daljes në rast se të gjitha daljet e reja nuk përshtaten në ekran. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | Kodi i NJVQV | Shfaqet kodi i entitetit për përdoruesin. |
| | Emri i NJVQV | Shfaqet emri i entitetit. |
| | Emri i programit | Shfaqet emri i programit të zgjedhur. |
| | Produkti | Kodet për produktet shtesë shfaqen pasi të jetë krijuar produkti shtesë. |
| | Produktet ekzistuese | Shpenzimet e hedhura për produktet ekzistuese shfaqen në këtë pjesë të ekranit. |
| | Total | Sistemi llogarit totalet për çdo produkt dhe për të gjitha produktet për çdo artikull. |
| | Kostoja për njësi | Sistemi llogarit koston për njësi si për produktet ekzistuese ashtu edhe për ato të reja. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri i Produktit | Përdoruesi vendos një emër për secilën prej produkt shtesë |
| | Njësia e matjes së produktit | Përdoruesi vendos emrin e njësisë për secilin prej produkteve shtesë, p.sh., hektarë, kilogramë, etj. |
| | Produktet e reja | Pasi të jetë krijuar një produkt shtesë, siç përshkruhet më sipër, përdoruesi duhet të klikojë butonin 'Ruaj' për ta ruajtur atë.<br><br>Pasi të ruhet, kodi i ri do të shfaqet në krye të dritares së produktit së ri dhe përdoruesi mund të hedhë sasitë dhe shpenzimet. |

| | |
|---|---|
| Sasia | Përdoruesi hedh sasinë shtesë të produktit për secilin prej produkteve ekzistuese dhe të reja. |
| Artikuj | Përdoruesi hedh shumën shtesë që kërkohet për çdo artikull të përshtatshëm për secilin prej produkteve të aplikueshme. |

### *11.4 Raportimi dhe miratimi i planifikimit të shpenzimeve të programit*

SMBV do t'i sigurojë përdoruesit lehtësinë për të printuar një sërë raportesh. Raportet e sistemit tregohen në Tabelën 1. Tabela përfshin dy kolona që identifikojnë raportet që DEMP-të duhet të printojnë dhe t'i paraqesin në KGMS.

Gjatë prezantimit të raporteve të PBA-së tek KGMSM për vitin aktual buxhetor, DEMP duhet të informojë KGMS me shkrim për çdo çështje për të cilën nuk është arritur konsensusi i EMP-së.

Kur paraqet raportet e PBA në SGSM për periudhën e PBA-së, DEMP duhet të informojë SGSM me shkrim për ndonjë nga sa vijon:

⇒ Çështjet për të cilat nuk është arritur konsensusi i EMP-së.

⇒ Nëse sasitë e produkteve të paraqitura në raportet e PBA-së janë të pamjaftueshme për të përmbushur objektivat e politikës së programit dhe standardet e politikave të përcaktuara në deklaratën e politikës së programit.

⇒ Ndryshimet e kërkuara për sasitë e produkteve dhe shpenzimet e aktivitetit të kërkuara për të përmbushur objektivat e politikës së programit dhe standardet e politikave të përcaktuara në Deklarimin e Politikës së Programit.

⇒ Ndryshimet e kërkuara në objektivat e politikës së programit, treguesit e performancës dhe standardet e politikave të përcaktuara në Deklarata e Politikës së Programit për konsistencë me sasitë e produkteve të paraqitura në Raportet e PBA-së.

KGMS duhet të tregojë miratimin e raporteve duke nënshkruar raportet.

Nëse KGMS konsideron se informacioni i dhënë në raportet e PBA-së kërkon një rishpërndarje të tavaneve të përgatitjes së PBA-së ndërmjet programeve, ai/ajo duhet t'i bëjë një propozim GMS-së për një shpërndarje të rishikuar të tavanit të përgatitjes së PBA-së për programet në fazën pasuese të përgatitjes së PBA-së.

Kur KGMS ka miratuar Raportet e PBA-së për një program, ai/ajo duhet t'i japë raportet GMS-së për miratim.

Nëse GMS nuk i miraton Raportet PBA-së për periudhën e PBA-së, ai duhet të diskutojë raportet me KGMS dhe të japë udhëzime për një ose më shumë nga sa më poshtë që duhet bërë.

⇒ Ndryshimi i Deklaratës së Politikës së Programit

Nëse kjo kërkohet, KGMS duhet të udhëzojë Drejtuesin(ët) e Ekipit(eve) të Menaxhimit të Programit që të rishikojnë deklaratën e politikës së programit në përputhje me udhëzimet e GMS-së.

⇒ Ndryshoni produktet e programit dhe/ose sasitë e produkteve

Nëse kjo kërkohet, KGMS duhet të japë udhëzime për procedurat që duhen ndjekur për programet për të cilat duhet të ndryshohen produktet ose sasitë e produkteve.

⇒ Rishpërndarja e Tavaneve të Përgatitjes së PBA-së për programet

Nëse kjo kërkohet, SGSM duhet të japë udhëzime për procedurat që duhen ndjekur për programet për të cilat do të bëhen alokimet e reja të tavanit të programit.

Kur GMS të ketë miratuar Raportet PBA-së për të gjitha programet, KGMS duhet të marrë masat që Dokumenti i PBA-së të dorëzohet në Ministrinë e Financave.

Dokumenti i PBA-së përbëhet nga raportet e mëposhtme dhe duhet të dorëzohet në Ministrinë e Financave me një shkresë përcjellëse nga Kryetari i NJVQV.

**Tabela 1– Raportet e PBA-së**

Raporti PBA1: Tavanet Përgatitore të PBA
Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)
Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA6: Deklarata së Politikës së Programit
Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit
Raporti PBA8: Projektet e Investimeve
Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin

**Tabela 2 - Raportet e Konsoliduara të MF**

Raporti MF1: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Nivelit I, II dhe III të COFOG.
Raporti MF2: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Kategorive Ekonomike
Raporti MF3: Të ardhurat e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Tabelës së të Ardhurave
Raporti MF4: Numri i punonjësve të NJVQV-ve sipas programeve dhe funksioneve qeverisëse

## 12. Përgatitja e Buxhetit Vjetor

Përmbajtja e dokumentacionit të buxhetit vjetor bazuar në kërkesat e nenit 40 të ligjit 68/2017 për Financat Vendore, është:

***Dokumentacioni Bazë***

Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese (në lekë) (neni 40, paragrafi 3.1.a)
Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve (në lekë) (neni 40, paragrafi 3.1.b)
Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave (në lekë) (neni 40, paragrafi 3.1.c)
Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik (në lekë) (neni 40, paragrafi 3.1.c)
Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV (neni 40, paragrafi 3.1.ç)

***Dokumentacioni Mbështetës***

Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore (neni 40, paragrafi 3.2.a)
Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV (neni 40, paragrafi 3.2.b)
Raporti BV8: Efekti Financiar I Përjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale (neni 40, paragrafi 3.2.c)
Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV (Neni 40, paragrafi 3.2.ç)
Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit (Neni 40, Paragrafi 3.2.d)
Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura (neni 40, paragrafi 3.2.e dhe paragrafi 3.2.h)
Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve (neni 40, paragrafi 3.2.e)
Raporti BV13: Lista e Projekteve Koncensionare / PPP (Neni 40, Paragrafi 3.2.f)
Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike (neni 40, paragrafi 3.2.g)
Raporti BV15: Plani i Arkës (neni 40, paragrafi 3.2.gj)

## *12.1 FB1. Detajimi i Buxhetit*

### A) Ekrani






## *12.2 FB2. Plani i Arkës*

Kjo është një tabelë e hedhjes së të dhënave.




| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali i Llogaritur | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 115 - Bashkia Gjirokastër | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 144913000.00 |
| Bashkia Gjirokaster (1111) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 144913000.00 |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 110195000.00 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 78880000.00 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 31315000.00 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 33718000.00 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 30078000.00 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 3640000.00 |
| Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1000000.00 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1000000.00 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

### *12.3 FB3. Lehtësimet Fiskale*

Kjo është një tabelë e hedhjes së të dhënave.



### *12.4 FB4. Plani i Menaxhimit të Riskut*

Ky ekran do të prezantohet në Versionin 2 të këtij manuali.

## _12.5 FB5 Subvencionet_

Kjo është një tabelë e hedhjes së të dhënave.



## 13. Moduli i Monitorimit të Performancës

Ky modul do të prezantohet në Versionin 2 të këtij manuali.

## 14. Proçesi i Miratimit të Dokumentacionit të PBA dhe Buxhetit Vjetor

Procesi i miratimit të formateve për PBA dhe Buxhetin Vjetor është një komponent kyç i procesit më të gjerë të përgatitjes së buxhetit në kuadër të Metodologjisë së Re. Ky proçes ndihmon në sigurimin e një rrjedhe efikase të informacionit, duke përfshirë detaje të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për aktorët e ndryshëm përfshirë drejtuesit e financave/buxhetit, drejtuesit e programeve, dhe organet e përgjegjshme për miratimin e dokumentacionit përfundimtar.

Për të pasuar me sukses këtë proces të ndërlikuar, është e rëndësishme të kemi një kuptim të thellë të rrjedhës së veprimeve dhe përdorimin e teknologjive të ndryshme për prezantimin e informacionit. Për të bërë më të qartë këtë proces, kemi përgatitur një diagramë rrjedhëse që do të udhëhoqë përdoruesin nëpër hapat kryesorë dhe kushtet për miratimin e informacionit në çdo fazë të përgatitjes së PBA dhe Buxhetit Vjetor.

Më poshtë paraqitet kjo diagramë.

## RRADHA E MIRATIMEVE (FAZA I & II) NË PROÇESIN E PËRGATITJES SË PBA



## RRADHA E MIRATIMEVE (FAZA III)
## NË PROÇESIN E PËRGATITJES SË PBA DHE BUXHETIT VJETOR



| Hapat | Miratimi | Kushtet paraprake të potësuara në SMBV | Aktori |
|---|---|---|---|
| **1** | Transfertat | Nuk ka | DFV/MF |
| **2** | Parashikimi të Ardhurave | Nuk ka | Zyrtari Përgjegjës për të Ardhurat, NJVQV |
| **3** | DPP1: Struktura e Programeve | Nuk ka | Kordinatori i GMS |
| **4** | DPP2: EMP | - Miratimi i DPP1: Struktura e Programeve;<br>- Ekziston vetëm një DEMP;<br>- Ekziston vetëm një SEMP;<br>- DEMP dhe SEMP nuk janë i njëjti person. | Kordinatori i GMS |
| **5** | PSHP1: Alokimi i Buxhetit të Vitit Korent | - Miratimi i Transfertave;<br>- Miratimi i Parashikimit të të Ardhurave;<br>- Miratimi i DPP1: Struktura e Programeve;<br>- Totali i Buxhetit Fillestar për Vitin Korent të të gjitha programeve, sipas të dhënave të hedhura në PSHP1, është i barabartë me Totalin e Planit Fillestar të të Ardhurave për Vitin Korent (minus Transfertën e Kushtëzuar);<br>- Totali i Buxhetit me Ndryshime të të gjitha programeve për Vitin Korent, sipas të dhënave të hedhura në PSHP1, është e barabartë me Totalin e Planit të Rishikuar të të Ardhurave për Vitin Korent (minus Transfertën e Kushtëzuar) | Zyrtari Përgjegjës për Financë/Buxhetin |
| **6** | PSHP2: Tavanet Përgatitore të PBA | - Miratimi i PSHP1: Alokimi i Buxhetit të Vitit Korent;<br>- Për secilin vit, Totali i Tavanit të NJVQV është i barabartë me Totalin e të Ardhurave (minus Transfertën e Kushtëzuar). | Kordinatori i GMS |
| **7** | PSHP3: Alokimi i Tavaneve për Programet | - Miratimi i PSHP2: Tavanet Përgatitore të PBA;<br>- Për secilin vit, Totali i Tavaneve të gjithë programeve për çdo grup artikujsh buxhetorë është i barabartë me Tavanin e atij grup artikulli në PSHP2. Pra, pjesët e paalokuara ende të tavaneve për të gjithë grup artikujt buxhetorë janë zero. | Kordinatori i GMS |
| **8** | DPP3: Deklarata e Politikës së Programeve | - Miratimi i PSHP3: Alokimi i Tavaneve për Programet;<br>- Miratimi i DPP2: EMP;<br>- Të gjitha fushat e DPP3 janë të plotësuara. | Drejtuesit e Programeve |
| **9** | Info Bazë e Programit | - Miratimi i DPP2: EMP | Drejtuesit e Programeve |
| **10** | PSHP6: Mangësitë në Financimin e Programit | - Miratimi i DPP3: Deklarata e Politikës së Programit; | Drejtuesit e Programeve |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Për çdo objektiv ka të paktën një produkt të lidhur me të;<br>- Për çdo projekt investimi, vlera e mbetur për vitet pas periudhës së PBA nuk është negative;<br>- Për vitin korent, për cdo artikull buxhetor, diferenca midis shpenzimeve të planifikuara ta programit dhe buxhetit me ndryshime është e barabartë me zero;<br>- Për secilin nga vitet e PBA, për cdo grup-artikujsh buxhetorë, diferenca midis shpenzimeve të planifikuara të programit dhe tavanit është e barabartë me zero. | |
| **11** | PSHP7: Kërkesat Shtesë | - Miratimi i PSHP6: Mangësitë në Financimin e Programit, për programin për të cilin do përgatitet kërkesa shtesë. | Drejtuesit e Programeve |
| **12** | NJVQV1 | Nuk ka | Kordinatori i GMS |
| **13** | NJVQV2 | - Miratimi i DPP1: Struktura e Programeve;<br>- Miratimi i DPP2: EMP<br>- Fusha 'Strukturat Përbërëse të Programit' janë të plotësuara për çdo program. | Kordinatori i GMS |
| **14** | NJVQV3 | - Miratimi i DPP1: Struktura e Programeve | Kordinatori i GMS |
| **15** | NJVQV4 | Nuk ka | Zyrtari përgjegjës për Financë/Buxhetin |
| **16** | NJVQV5 | - Miratimi i DPP1: Struktura e programeve | Zyrtari përgjegjës për Financë/Buxhetin |
| **17** | NJVQV6 | Nuk ka | Kordinatori i GMS. |
| **18** | FB1: Detajimi i Buxhetit | - Miratimi i NJVQV6: Njësitë Shpenzuese;<br>- Miratimi i PSHP6: Mangësitë në Financimin e Programit për secilin nga programet e shpenzimeve;<br>- Shpenzimet e Mbetura të të gjitha Projekteve ose Produkteve duhet të jenë zero;<br>- Totali i Shpenzimeve të Detajuara nga një burim me destinacion përkon me totalin e transfertës përkatse nga Buxheti Qëndror. | Zyrtari përgjegjës për Financë/Buxhetin |
| **19** | FB2: Plani i Arkës | - Miratimi i FB1: Detajimi i Buxhetit Vjetor për secilin Program;<br>- Totali i Planit të Arkës duhet të jetë i njëjtë me totalin e Buxhetit Vjetor të të gjitha Programeve. | Zyrtari përgjegjës për Financë/Buxhetin |
| **20** | FB3: Lehtësimet Fiskale | Nuk ka. | Zyrtari përgjegjës për të Ardhurat |
| **21** | FB4: Plani i Menaxhimit të Riskut | Nuk ka | Kordinatori i Riskut |
| **22** | FB5: Subvencionet | Nuk ka | Zyrtari përgjegjës për Financë/Buxhetin |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **23** | Miratimi i PBA/BV nga Kordinatori i GMS | - Miratimi i të gjitha formateve për të gjitha progrmet. | Kordinatori i GMS |
| **24** | Miratimi i PBA/BV nga Kryetari i GMS | - Miratimi i PBA/BV nga Kordinatori i GMS | Kryetari i GMS |

## 15. Përmbledhje e Raporteve

### *15.1 Raportet e PBA-së*

*15.1.A Raportet e Konsoliduara të MF*

Raporti MF1: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Nivelit I, II dhe III të COFOG.
Raporti MF2: Shpenzimet e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas kategorive ekonomike
Raporti MF3: Të ardhurat e detajuara dhe agregate të NJVQV-ve sipas Tabelës së të Ardhurave
Raporti MF4: Numri i punonjësve të NJVQV-ve sipas programeve dhe funksioneve qeverisëse

*15.1.B Raportet e PBA-së së NJVQV-së*

Raporti PBA1: Tavanet Përgatitore të PBA
Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)
Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
Raporti PBA6: Deklarata së Politikës së Programit
Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit
Raporti PBA8: Projektet e Investimeve
Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin

### *15.2 Raportet vjetore të buxhetit*

*15.2.A Raportet e Buxhetit Vjetor të NJVQV-së*

Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese
Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve
Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave
Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik
Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV
Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore
Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV
Raporti BV8: Efekti Financiar I Përjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale
Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV
Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit
Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura
Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve
Raporti BV13: Lista e Projekteve Koncensionare / PPP
Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike
Raporti BV15: Plani i Arkës

### *15.3. Raportet e Monitorimit të Performancës*

*15.3.A Raportet e Konsoliduara të Monitorimit të Performancës [MF]*

Raporti 1 i Monitorimit të Performancës 1 të MF-it:

Raporti 2 i Monitorimit të Performancës së MF-it:
Raporti 3 i Monitorimit të Performancës së MF-it:
Raporti 4 i monitorimit të performancës së MF-it:
Raporti 5 i Monitorimit të Performancës së MF-it:

*15.3.B Raportet e Monitorimit të Performancës [NJVQV]*

Raporti MON 1: Shpenzimet sipas programit
Raporti MON 2: Shpenzimet e programit sipas klasifikimit ekonomik
Raporti MON 3: Performanca e rezultateve të programit
Raporti MON 4: Arritja e objektivave të politikës programore
Raporti MON 5: Projektet e investimeve të financuara vendore dhe të huaja

## 16. Shtojcë 1. Planifikimi i Shpenzimeve në Nivel Aktiviteti

MF kërkon raportimin e planeve të shpenzimeve të programeve në nivel produkti. Megjithatë, për qëllimet e tyre menaxheriale dhe për të mundësuar lidhjen me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, NJVQV mund të vendosin të realizojnë planifikimin e shpenzimeve të programit në nivelin e aktivitetit, gjë e cila mundësohet edhe nga SMBV. Në të ardhmen SMBV do të mundësojë që aktivitet dhe shpenzimet e tyre të mund të lidhen me planin e prokurimeve që NJVQV duhet të hartojë për zbatimin e buxhetit vjetor.

Për të realizuar planifikimin e shpenzimeve në nivel aktiviteti, në Panelin e NJVQV përdoruesi duhet të klikojë në butonin me ngjyrë të kuqe: **Zgjidhni Nivelin e Planifikimit të Shpenzimeve** siç tregohet në ekranin e mëposhtëm.




Në vijim, në ekranin pasues që hapet, përdoruesi duhet të klikojë në butonin: **Sipas Aktiviteteve**. dhe SMBV për NJVQV në fjalë do të konfigurohet që të mundësojë krijimin e aktiviteteve për secilin projekt dhe produkt si dhe planifikimin e shpenzimeve në atë nivel.




**Vendim-marrja për zgjedhjen e mënyrës së planifikimit të shpenzimeve në nivel produkti apo në nivel aktiviteti duhet të realizohet përpara fillimit të punës me ekranet PSHP4 dhe PSHP5 të SMBV.**

Sidoqoftë, përdoruesi mund të vendosë në çdo kohë të ndryshojë nivelin e planifikimit të shpenzimeve, duke pasur parasysh implikimet e mëposhtme:

- Nëse kalohet nga planifikimi në nivel produkt në planifikimin në nivel aktiviteti, sistemi do të fshijë çdo shpenzim të hedhur në nivelin e produktit/projektit deri në momentin e ndryshimit. Pas ndryshimit, përdoruesi do të duhet të krijojë aktivitetet për secilin projekt/produkt dhe të hedhë shpenzimet në nivelin e aktivitetit.
- Nëse kalohet nga planifikimi në nivel aktiviteti në planifikimin në nivel produkti, sistemi do të fshijë të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse të hedhura në sistem deri në momentin e ndryshimit. Pas ndryshimit, përdoruesi do të duhet të hedhë shpenzimet në nivelin e produktit.

**Aktivitetet**

Pasi të identifikohen produktet e programit për çdo vit, hapi tjetër në këtë proces është renditja dhe përshkrimi i aktiviteteve që do të jenë të nevojshme të ndërmerren për të ofruar çdo produkt të programit për atë vit.

*Aktivitetet* përkufizohen si:

⇒ Veprimet e ndërmarra për të realizuar një produkt- aktivitete të shumta mund të ndërmerren për një produkt.

Aktivitetet e produkteve të programit janë paraqitur në PSHP5. Ky ekran kërkon që Ekipi i Menaxhimit të Programit të emërojë dhe të përshkruajë aktivitetet e nevojshme për të realizuar çdo produkt për programin në çdo vit.

Pas identifikimit të produkteve të programit për një vit të caktuar, DEMP-ja duhet të thërrasë një takim me EMP-në për të diskutuar dhe konsultuar me stafin teknik nëse është e nevojshme, dhe për të kërkuar marrëveshje ose konsensus mbi aktivitetet e nevojshme për të ofruar çdo produkt të programit gjatë atij viti.

Pasi të arrihet marrëveshja ose konsensusi brenda EMP për çdo produkt që do të realizohet nga programi gjatë vitit të specifikuar, DEMP duhet të regjistrojë emrat e aktivitetit dhe përshkrimet e aktivitetit në PSHP5.

Gjatë regjistrimit të aktiviteteve për një produkt të një viti të caktuar, SMBV i lejon përdoruesit të tregojnë nëse aktivitetet nga vitet e mëparshme për atë prodhim do të vazhdojnë apo do të ndërpriten. Përdoruesit e tregojnë këtë duke specifikuar nëse aktivitetet janë aktive apo joaktive. Çdo vit, sistemi shfaq të gjitha aktivitetet aktive dhe joaktive për produktet e ruajtura në EMP nga nën-ciklet e mëparshme, duke lejuar që aktivitetet e mëparshme joaktive të riaktivizohen aty ku është e nevojshme.

Kur një aktivitet i ri krijohet për një prodkt, SMBV cakton një kod rendor për aktivitetin.

Kur arrihet marrëveshja, ose të paktën konsensusi brenda EMP-së për emrat dhe përshkrimet e aktiviteteve për një produkt, DEMP duhet të zgjedhë aktivitetet ekzistuese që duhet të vazhdojnë, të çaktivizojë aktivitetet e ndërprera dhe të japë emra dhe përshkrime për aktivitetet e reja. në seksionet përkatëse të PSHP5.

## A) PSHP5: Skema e procesit




Vijon nga ①
EMP identifikon 'Aktivitetet' për çdo Produkt
zgjidh PSHP5 nga menuja PSHP
Përdoruesi është anëtar i MF?
Jo
Po
Sistemi zgjedh entitetin e përdoruesit
zgjidh Entitetin nga menuja
Kodi dhe emri i Entitetit nga databaza, zgjidhen nga menuja në PSHP5. Përdoruesi MF vetëm mund të lexojë por nuk ndryshon dot.
zgjidh 'Programin' nga menuja
Kodi dhe emri i programit nga databaza, zgjidhen nga menuja në PSHP5
Sistemi shfaq Shpenzimet e Planifikuara, Tavanin dhe Mangësitë në Financim për Programin
zgjidh Produktin
Kodet dhe emrat e Produkteve shfaqen nga databaza
Ekzistojnë aktivitete nga vitet e mëparshme?
Po
zgjidh Aktivitetin
Aktivitetet nga vitet e mëparshme shfaqen në PSHP5
zgjidh vitet kur realizohet
Jo
përditëso përshkrimin për çdo vit
Jo
U përditësuan të gjithë Aktivitetet ekzistuese?
Po
Databaza e SMBV
shtyp 'Krijo Aktivitet të Ri'
Sistemi gjeneron kodin e aktivitetit
hidh Emrin dhe Përshkrimin e Aktivitetit
Zgjidh vitet në të cilat do realizohet Aktiviteti
Jo
U hodhën të gjitha Aktivitetet?
Informacioni për Aktivitetet rregjistrohet në databazë
Po
Jo
U hodhën Aktivitetet për të gjitha Produktet?
Yes
Ruaj informacionin e hedhur
Vijo me 'Shto Shpenzimet'

B) PSHP5: Ekrani

B.1) PSHP5: Pema e Programit



B.2) PSHP5: Aktivitet i ri




C) PSHP5: Përshkrimi i të dhënave: Aktivitetet

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Shënoni kutinë | 2024 Viti fiskal | Përdoruesi shënon këtë kuti për të treguar se ky produkt (apo aktivitet, sipas rastit) do të realizohet në vitin në fjalë. |
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes ndodhen në anën e djathtë dhe në fund të ekranit, si dhe pranë përshkrimit të produktit, në rast se informacioni nuk mund të shfaqet në ekran njëkohësisht. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe Emërtimi i entitetit shfaqen nga sistemi në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i programit shfaqen nga sistemi në varësi të përkatësisë programore të përdoruesit. |
| | Kodi i Produktit | Çdo produkti të ri që krijohet i caktohet një kod automatik nga sistemi, bazuar në funksionin që i përket dhe NJVQV që e ka krijuar. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Emri i aktivitetit | Emri i Aktivitetit të përdorur nga NJVQV-ja për t'iu referuar aktivitetit. |
| | Përshkrimi i aktivitetit | Çdo aktivitet duhet të përshkruhet shkurt dhe qartë. |

## *16.1 Planifikimi i Sasisë dhe Shpenzimeve të Aktiviteteve*

Pas identifikimit të aktiviteteve të programit, EMP duhet të përcaktojë objektivat sasiore për produktet e programit dhe të identifikojë shpenzimet e nevojshme për financimin e aktiviteteve për arritjen e produkteve të programit.

Sasitë e planifikuara dhe shpenzimet e aktiviteteve janë paraqitur në ekranin Shpenzimet e Aktivitetit. Ky ekran aktivizohet duke klikuar në ikonën në cepin e produktit për të cilin do të planifikohen shpenzimet, dhe duke zgjedhur opsionin 'Shto Shpenzimet', komandë e cila aktivizon ekranin e mëposhtëm.




Ekrani i ri që hapet kërkon që Ekipi i Menaxhimit të Programit të përcaktojë sasinë e produktit dhe të identifikojë shpenzimet për secilin aktivitet për secilin nga vitet.

DEMP duhet të thërrasë një takim të EMP-së për të arritur marrëveshje ose konsensus mbi sasitë e produkteve të programit dhe kërkesat për shpenzime për aktivitetet e programit (në nivelin e shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë) për produktet e programit për secilin vit.

Kur është arritur konsensusi ose marrëveshja e EMP mbi sasinë e produktit dhe shpenzimet e aktiviteteve përkatëse për vitin e nënciklit në fjalë për çdo produkt të programit, DEMP duhet të hedhë në ekranin e mësipërm:

⇒ Sasitë e planifikuara për produktet

⇒ Shpenzimet për çdo aktivitet, sipas artikujve buxhetorë

Sasia e produktit dhe shpenzimet e aktivitetit duhet të hidhen për çdo produkt me radhë.

A) Skema e procesit



B) Ekrani

B.1) Planifikimi i shpenzimeve në nivel aktiviteti



C) Përshkrimi i të dhënave

| Titujt | Emërtimi në Ekran | Përshkrimi i Funksionalitetit |
|---|---|---|
| Shiritat e lëvizjes | Shiritat e lëvizjes janë të disponueshme në të djathtë, në rast se informacioni nuk përshtatet i gjithi në ekran. | |
| Kutitë e të dhënave të sistemit | NJVQV | Kodi dhe emërtimi i NJVQV shfaqen automatikisht nga sistemi në varësi të përkatësisë institucionale të përdoruesit. |
| | Programi | Kodi dhe emërtimi i Programit shfaqen automatikisht nga sistemi në varësi të përkatësisë programore të përdoruesit. |
| | Produkti | Kodi dhe emërtimi i Produktit të zgjedhur për planifikimin e shpenzimeve shfaqen automatikisht nga sistemi. |
| | Aktiviteti | Emërtimi i aktiviteteve të produktit shfaqet automatikisht nga sistemi. |
| | Njësia e matjes | Emri i njësisë matëse të produktit, p.sh., hektarë, kilometra, etj. |
| | Shpenzimet për Njësi | Shpenzimet për njësi produkti si raport midis totalit të shpenzimeve të produktit dhe sasisë së produktit për vitin e dhënë. |
| Kutitë për plotësim nga përdoruesi | Sasia | Sasia e produktit që do të realizohet gjatë vitit në fjalë. |
| | Shpenzimet e aktivitetit | Shpenzimet sipas artikujve për çdo aktivitet për vitin e dhënë, kur planifikimi i shpenzimeve bëhet në nivel aktiviteti,. |
| | Shpenzimet e produktit | Shpenzimet sipas artikujve për çdo produkt për vitin e dhënë, kur planifikimi i shpenzimeve bëhet në nivel produkti. |